

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVIII i botimit, nr. 212, Qershor 2021

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Grupi folklorik "Besa Shoshi" pjesëmarrës në festivalin "Sofra Dardane-2021" 3

Grupi Folklorik "Besa Shoshi", në këtë festival ishte i ftuar nga Presidenti i Unionit të Kombit Shqiptar, Azgan Haklaj. I vetmi grup folklorik nga Shkodra, që merrte pjesë në këtë festival. Festivali u zhvillua për tre netë me radhë, në qytetin "Bajram Curri", me datën 10 -11-12 qershor 2021, në stadiumin e lojërave me dorë. Në këtë stadium zbriten këngëtar, valltarë, artiste nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga diaspora. Ne ishim prezent, që natën e parë të këtij festivali, që edhe konkurruam.



Një udhëtim i bukur në rrafshin e Dukagjinit 11

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, si çdo vit, edhe këtë vit, megjithëse ende nuk është larguar pandemia, ajo mori guximin e organizoi Manifestimin-2021, me temë patriotike: "Sakrifica Kombëtare për Liri e Pavarësi", me datën 12 qershor 2021, në Rugovë-Rugova Kamp. Në këtë veprimtari morën pjesë nga të gjitha trevat veriore shqiptare, që nga Mali i Zi e deri në Kosovën Lindore, dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", gjithsejtë rreth 50 pjesëmarrës.



XHUBLETA - VESHJE ILIRO-PELLAZGE QË RUHET ENDE NË DITËT TONA 7

Xhubleta është një veshje tipike e grave në Shqipërinë Veriore, në Malësinë e Madhe, Rugovë, Dukagjin dhe trevat shqiptare në Malin e Zi. Xhubleta është një fund në trajtë këmbane, dhe me vjën e valëzuar përfundi. Përbëhet nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, të vënë horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supe me dy rripa të gjërë dhe vazhdon me pjesët përbërëse me një lloje jeleku ...



Çështje Nderi

një meditim i shkurtë në muajt e nxehtë të diellit 616, mbas Trojës

Për çudi, nuk ishte i verbër. Është bërë traditë a së paku zakon që, ndërsa këndohen ato këngë të lavdishme, ata që dëgjojnë presin që rapsodi të jetë i verbër. Nuk e di pse ka lindë kjo legjendë, apo kjo pritshmëri. Për sa më ka rastisë të jem i pranishëm, kurrë ndonjëherë nuk kam parë të jetë i verbër. Ndoshta ky është një figuracion, që ka lindur mbase për të theksuar përkushtimin e rapsodit, a për ta bërë atë, jo vetëm transmetues, por edhe përjetues të atyre ngjarjeve; verbëria e tij është lypur e nevojshme, për të treguar se ai tjetër nuk jeton, a përjeton, ...



Pishat e parkut Nderlysa po vdesin nder sytë tanë

Po ku je moj Dilë Picja?

Po mana po vdesin. Po vdesin per së shkreti si mall i pa Zot. Ato po piskatin:

- Ndhimë se mbaruan! Po kujt t'i therësin ato bukuroshe të shkreta?! Askush nuk ka gojë, askush nuk ka forcë tu shkojë në ndihmë. E pra, syri lotit trishtohet përpara një epidemie vraste bash në hundën tonë krenare. Pishat e Gagut, Lekajve, Nderlyses dhe Thethit ku shumë, e ku pak më lehtë janë goditur nga sëmundja e procesionares.

Epidemia ka vite që është shfaqur në mënyrë sporadike, ndërsa tani ka fituar terren, duke shkaktuar dëmtime të pa riparueshme. Inspektoriati i pyjeve në qarkun e Shkodrës nuk ka asnjë të dhënë sa është në shifra sipërfaqja e prekur, nëse do të ketë ndërhyrje nga toka apo ajri. Siç më tha një mik specialist pyjesh Procesionarja e dëmtion pishën në mënyrë të pakthyeshme nëse nuk ndërhyhet në kohë duke shkaktuar tharjen e plotë të saj. Ajo luftohet në mënyrë mekanike, duke i mbledhur insektet, sa janë ende në boçen e tyre dhe më pas digjen. Madje kjo njihet ndryshe si forma më e mirë e luftimit, pasi dezinfektimi nga ajri mbetet më sipërfaqësor. Të dhënat

tregojnë se procesionarja ka aftësi shumë të jashtëzakonshme, pasi flutura mund të zhvendoset në një hapësirë 10 deri në 15 kilometra. As gjë nuk është bërë, ndërkohë lufta duhet të jetë e vazhdueshme për të shpëtuar pyjet. Edhe një brigadë e vogël me shkalla e mjete të thjeshta me anë të djegies brenda kësaj verë do ta nxirret pishën



Në fshatin Nderlysa

e Shalës nga reminacioni. Në unison të plotë me relievin shkëmborë natyra në mënyrë fine na ka dhuruar një vello halore me forma konike, qe me

kalimin e viteve behet jo e rregullt me pisha nga më të njomat deri tek ato qindra vjeçare, dritëdashëse të hijshme, kurative dhe shumë rezistente ndaj akullit dhe bores:

Gjethet (halat) janë të vendosura dyshe në majën e filizave të shkurtër dhe në bazë mbështillen nga luspa të murrme. Ky vargua organik mes

po vdes! Çatia halore po shembet dhe rrënohet. Janë mijra e mijra sy, që shohin me trishtim. Janë qindra e mijra zemra, që dhëmbin në heshtjen e tyre vetmitare.

Heshtje, heshtje, dhe kapitullim pa kushte ndaj një fatkeqësie jo të pa përballueshme. Askush nuk e merr mundimin të bëjë diçka, as ata që paguhen ta menaxhojë pyjet, as nga bashkësia që lutet e bekon "hali" të reja "mrekullibërëse", as nga organizata e shoqëri mjedisore. Unë po thërras sa të kem fuqi. Po kujt me i thirr ndihmë, Zotit që nuk besojmë as lemë gjë pa be emër të tij, dashurive tradhtarë politike, apo Dilë Picës?!

Besa askush veç teje moj Dilicë nuk mendon as për pishat, as për gështenjat që po thahen të gjitha, as për hallet e vegjëlisë. Oj Dilë! Oj sojnikë e moçme çohu nga amshimi dhe na sjell shpëtimin mjedisorë! Thethi dhe aq më tepër Zalli i Nderlyses po të zhvishen nga kostumi halorë marrin pamjen e një kllaçe pa pupla, që do të thotë tragjedi turistike. Çohu oj Dilë se, këtij vendi ju ka pre ora! Ora jote na priftë e na shpëtoftë!

Prelë MILANI

NJË JETË E SHPËTUAR NGA POLICIA DHE BANORËT E THETHIT

Turistja polake ANA WOUZHNJA 35 vjeçe ka mbetur e bllokuar dhe e lënduar me thyerje të këmbës së djathtë dhe me hematoma në kokë pas një shkarje në një parg, në masivin e Jezercës, me lartësi mbi 2300 metër mbi nivelin e deti.

Ngjarja ka ndodhur diku mes Tropojës dhe Thethit, atje ku bora zbardhon pa iu trembur askujt. Ka qene ndërhyrja e forcave të Postes së Policisë së Thethit dhe banoreve të fshatit, të cilët kane bere të mundur shpëtimin e jetës së vizitores polake.

Evakuimi i saj ka zgjate mbi 10 ore mes një terreni tepër të thyer alpin. E dëmtuara është transportuar dorazi me barelë deri në livadhet sipër Thethit. Pastaj, me helikopter është dërguar për ndihme emergjente në Tiranë, e cila tashme është jashtë rrezikut për jetën.

Ndërhyrja e policisë dhe banoreve të

fshatit ka qene sakrifice dinjetoze, humane dhe tej e guximshme. Zotërite Leke Gerrla, Nikoll Djegjsina dhe Tome Shyti kane kaluar natën me të dëmtuarën, duke dhëne ndihmën e pare, ndezur zjarrin e dërguar rroba se, përndryshe e dëmtuara do kishte vdekur nga të ftonit. Më pas kane zbritur dhe kërkuar ndihmën e efektiveve të postes së Policisë së Thethit, Gjergj Marku, Zef Tinaj e Gjergj Ndershtiqni, duke kryer së bashku evakuimin e 35 vjeçares.

Shqipëria dhe shqiptaret janë njerëzit më të gjendur e sakrifikues në Evropë, në çastet më dramatike të jetës së një personi pa pyetur se kush është ai.

Ta ruajmë ketë tradite të mirësishtë!

Prele Milani



Grupi folklorik “Besa Shoshi” pjesëmarrës në festivalin “Sofra Dardane-2021”

Grupi Folklorik “Besa Shoshi”, në këtë festival ishte i ftuar nga Presidenti i Unionit të Kombit Shqiptar, Azgan Haklaj.

I vetmi grup folklorik nga Shkodra, që merrte pjesë në këtë festival.

Festivali u zhvillua për tre netë me radhë, në qytetin “Bajram Curri”, me datën 10 -11-12 qershor 2021, në stadiumin e lojërave me dorë.

Në këtë stadium zbriten këngëtar, valltarë, artiste nga të gjitha trojet shqiptare dhe nga diaspora. Ne ishim prezent, që natën e parë të këtij festivali, që edhe konkurruam.

Në këtë festival morën pjesë mbi 40 grupe dhe shoqëri kulturore, më shumë se një mijë artistë nga të gjitha trojet shqiptare brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Grupi “Besa Shoshi” u paraqit me këngëtarët më të mirë të saj: Gege Zefi, Ndue Kol Fusha, Kol Martin Aramadhi, Gjesh Kola, Gjon Kosteri e Ndoc Fusha.

Ne u paraqitem me këtë program, folklori i pastër: Me këngë maja krahu, këngë me lahutë, këngë, putira, këngë me sharki e çifteli dhe në fund me gjamen e burrave.

Me mbërritjen tonë në qytetin e Bajram Currit interesi i mediave vendase dhe të huaja ishte mjaft i madh, për faktin se e dinin, që ne do të paraqiteshim në këtë festival, me këngën maja krahu dhe gjamen e burrave, më të cilat nuk i paraqiste asnjë grup tjetër, të cilat ishin publikuar me pare nga organizatorët e këtij festivali.

Me ne u bashkëbisedua nga televizione lokale dhe kombëtare si dhe nga Zëri i Amerikës-seksioni shqip.

Gjithashtu na u kërkua të aktronim pjesë muzikore edhe jashtë skenës, pranë monumentit Bajram Curri, për televizione të Kosovës.

Pas një dite shumë aktive pasdite u ba parakalimi ceremonial i gjithë grupeve pjesëmarrëse të natës së parë të festivalit “Sofra Dardane-2021”.

Ishte një festë e vërtetë, një panoramë shumëngjyrshëm, me kostumet e mrekullueshme tradicionale nga gjitha trevat Shqiptare. Edhe këtu grupi jonë dallonte, për kostumet origjinale dhe shumë cilësore, por veçanërisht për Flamurin e Shoqatës, i cili ishte i mrekullueshëm dhe u pëlqye shumë nga personalitete dhe nga shumë qytetar, që kërkonin ta fotografonin dhe të bënin foto pranë tij.

Pas një ore më shumë, që zgjati parakalimi erdhi koha e konkurrimit të grupeve pjesëmarrëse. I gjithë stadiumi i lojërave me dorë i qytetit të Bajram Currit ishte mbushur plotë e për plote me shikues. Një feste e vërtete me shumë ngjyra nga trojet mbarëkombëtare

Grupet zbriten në skenën gjigande të festivalit me radhë. Ne zbritem në skenë si ortek bjeshke me shumë dinjitet dhe me shumë nivel. Të gjithë numrat, njeri më i mirë se tjetri, të cilat u ndoqën me shumë interes, në veçanti kënga maja krahi dhe gjama e burrave, u duartrokiten

Ne ishim të ftuar që të rrinim tre netë,

por për pamundësitë tona financiare, nuk mundem të qëndronim më shumë se një natë, pavarësisht se na u kërkua me ngulm të qëndronim deri në mbarim të festivalit.

Pas tre ditësh, në natën e fundit Juria e festivalit vlerësoj të gjitha grupet pjesëmarrëse dhe individ të veçantë. Grupi jonë “Besa Shoshi” u vlerësua me çmim të PARË, grupi më i mirë në ruajtjen interpretimin dhe kultivimin e folklorit të pastër. Ndërsa “Gjama e burrave” u vlerësua me çmim të PARË, si numri më i lashtë, më origjinal dhe i interpretuar

me shumë origjinalitet. Gjithashtu u nderuam me titullin më të lart të këtij festival “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”.

Grupi jonë “Besa-Shoshi” u kthye nga festivali “Sofra Dardane”, me dy çmime. Për këtë ndjehemi shumë krenar dhe falënderoj gjithë shokët e grupit. Falënderojmë, në mënyrë të veçantë anëtarët e Jurisë për vlerësimin që na bënë. Gjithashtu falënderojmë, Presidentin e Unionit të Kombit Shqiptar, zotin Azgan Haklaj dhe Kryetarin tonë, Ndoc Fusha, që na mundësoi pjesëmarrjen në këtë festival.

Grupi jonë gjate kësaj Vere, është i ftuar edhe në festivale të tjera, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, si dhe në veprimtari kulturore brenda vendit.

Ne, çdo ditë e përmirësojmë performancën tonë me këngë të reja e të vjetra, me element të ri. Detyra e jonë është ta ruajmë folklorin e pastër dhe ta përçojmë tek brezi i ri ashtu siç ka qene. Por kërkojmë dhe mbështetjen e pushtetit vendor, i cili deri tani është i pakte.

Gjon KOSTERI



Profesor Ismet Azizi në Shkodër

Me datën 19 qershor 2021, në hotel “Rozafa” nën kujdesin dhe organizimin e kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Malësia”, Ilmi Kurti u zhvillua një veprimtari promovuese të librit, me titull “Aqif Blyta, kolos në Pazarin e Ri”, te autorit prof. Ismet Azizi, nga Gjilani.

Në kete veprimtari moren pjese dhjetra personalitete te letersise, si poet, publicist, shkrimtar, studiues shkencor, gazetar, media dhe anëtar të shoqërisë civile.

Autori i librit, prof. Ismet Azizi, një aktivist i madh i çështjes kombëtare ndër vite dhe kryetar i Shoqatës “Kosova për Sanxhakun”.

Hapi kete promovim libri, organizatori Ilmi Kurti, duke i përshëndetur të pranishmit dhe uruar autorin e librit, qe beri te mundur te bashkohemi, prof. Ismet Azizi.

Për librin gjerësisht folën zonja poetja Prenda Sejdia, prof. Nail Draga, studiuesi Prele Milani, shkrimtari Ali Daci dhe Nuredin Imeraj (nga Istogu, përfaqësues i Klubi Letrar Podguri).

Në fund si zakonisht fjala iu dha autorit të librit, i cili me modestinë e tij sikur ua la emocioneve krenare shqiptare, duke e shprehur gëzimin që ëndërra e tij sot po realizohet duke iu promovu libri në shtetin



shqiptar që para vetëm dy dekada ishte vetëm ëndërr, emocionet e tij dhe tonat u bënë vlerë e shtuar për faktin se po promovohet mu në Shkodren tonë, në vendin e kulturës dhe emancipimit, mikëpritjes dhe bujarisë, në vendin rezistencës kombëtare ndër shekuj.

Autorit të librit, prof. Ismet Azizit, kry-

etari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj, me këtë rast i dhuroi librin, me titull “Dukagjini, Shqipëria ime aty”, refleksione, pjesa e dyte, me të cilin prof. Ismeti e ndjeu veten më të lartësuar.

Pas përfundimit të kësaj veprimtarie pati edhe ceremoni miqësore duke dhuruar libra njeri tjetrit.

Vlerë e shtuar e kësaj veprimtarie ishte nxënësja e klasës së pestë, Besarta Shkozja, e cila më dhuroi librin e saj të parë “TË ISHA ZOG”. Kjo më gëzoi shumë, tejmase, por edhe më solli emocione duke me mbushur me premtime se e ardhmja e ndritur po vjen bashkë me breza.

Veprimtaria nuk mbaron, sepse amaneti nuk mbahet peng, Bajram Halil Gashi, publicist i njohur, veteran i arsimit, i cili përkohësisht gjendet në Itali në momentin që e ka kuptuar se në Shkodër do të ketë promovim libri, më dërgon 4 libra voluminoze të botuara më parë për t’ua dhuruar z. Ndue Sanaj, Ismet Azizit, Ali Dacit dhe Ilmi Kurtit.

I gjithë kjo veprimtari me vlera kombëtare nuk do të kishte kuptimin pa RTV Fontanën në krye me drejtorin e kësaj shtëpi prestigjioze, Zeqir Mehmetaj, i cili erdhi enkas nga Istogu, për ta përcjellë plot për dy orë, të cilin për zemërsisht e përshëndeti autori i librit, prof. Ismet Azizi. Dhe si zakonisht burrat e Shkodrës nuk mungojnë asnjëherë për mikpritje dhe bujari.

I nderuari, Irfan M. Domniri për respekt shtroj drekë vëllazërore buzë lumit Buna.

Nuredin IMERAJ, Istog

Aqif Blyta, KOLOSI I PAZARIT TË RI

Në librin historik ‘Aqif Blyta Kolosi i Pazarit të Ri, autori vjen si një lëvrues i historisë tek hedh, dhe dritë- hijet mbi një nga figurat e njohura të fillim shekullit 20, ku përshkruan në mënyrë të detajuar jetën dhe veprimtarinë e këtij patrioti që në moshën 10- vjeçare e deri në flimjim.

Kështu që figura e Aqif Blytës për disa dekada jo vetëm që ju mbijetoi fatit të shumta, por ai tregoi fuqi e gëzoi mbështetje popullore jo vetëm në Novi Pazarin e sotëm, por në shumë teritore me origjinë shqiptare e më gjerë.

Kështu pra, Novi Pazar qe një nga qendrat e njohura tregtare në këtë pjesë të qendrës së Gadishullit Ballkanik, ku Blyta qe organizator i kuvendit të përkrahësve të Xhemijetit, ndaj dhe të pranishmit kërkonin bashkim të popullsisë myslimane shqiptare, dhe ndikimi qe tek turqit e Maqedonisë dhe shqiptarët e Kosovës.

Qasja autoriale është një vrap drejt njohjeve dhe fakteve e fenomeneve historike mbi këtë figurë që historia e njeh në këto rajone shqiptare, të atyre kohërave shumë të vështira dhe botimi i cili do arkivohet në arkivat e kohës si testament në procese delikate e të rëndësishme të cilat do i shërbejnë brezave dhe njohja është vlerë e pasuri kombëtare.

Shkrimtari në këtë libër historik me shumë ndjenjë e përkushtim sjell fakte interesante dhe librin e bën të pakontestueshëm dhe mjaft atraktiv për masën e gjerë.

Në kontekstin kohorë, zhvillimit dhe kronologjisë së ngjarjeve të shumta e

në situata të ndryshme Blyta merr role përcaktuese duke synuar eksplorime në kuadrin e zhvillimeve të ngjarjeve dhe gjetjen e alternativave më të mira të bashkëpunimit me popullsinë myslimane shqiptare, si aktivitet që do i jepte gjallëri zonës por dhe popullit në gjithë trojet e Maqedonisë dhe Kosovës.



Prof. Ismet Azizi

Shpeshherë duket kontroverse në raport me interesat nacionaliste e kombëtare për mbrojtjen dhe zhvillimin e me synime specifike të detyrave, dhe marrjen përsipër të përgjegjësisë, sidomos në ndarjen e popullsisë myslimane dhe katolike, dhe sipas mendimit tim çështja kombëtare ka pak të çaluar në këtë aspekt, pasi mbështetja ishte veçse për partinë e Xhemijetit, pra Turqisë.


Megjithëse..

Vlerat stilistike e historike të këtij libri nxjerrin në pah vlerat reale të figurës pop-

ullore e politike të Aqif Blytës.

Pena e Ismet Azizit sjell në kornizim specifik mjaft të gjerë e i përshtatet opinionit me ngjarjet e shumta reale dhe vjen për lexuesin me unë e tij origjinal mjaft të gjerë e të detajuar.

Me ngjarje dhe personazhe reale dhe ndër kohë pasuron historinë e kombit



duke hedhur dritë mbi errësirën shekullore në gjithë dekadat e shkuara, të cilën do e studiojnë vetë gjeneratat gjithë këtë larmi kapitujsh, dhe figura kryesore qëndron Aqif Blyta një personazh i shkolluar, intelektual, me vlera shoqërore dhe politike, me karrierë parlamentare dhe si deputet arrin në Komisionin e Financave në Parlament por ideator dhe veprimtarë në fusha të tjera si tregtarë a bankier e të tjera.

Blyta qe pengesë e madhe madje shpesh bëhej barrierë e realizimeve të

planeve e projekteve serbe që paraprinin për Sanxhakun.

Blyta tregonte maturinë dhe shpirtin atdhetarë ndaj autori vlerësohet për detajimin e veprimeve të Blytës në tërë mënyrat e përgatitjes profesionale, shkollimit, aktivitetit politik etj.

Por dhe besimin që Blyta kish tek vetja e tek të tjerët në marrëdhënie dy a më shumë paleshe, duke shtuar vetëdijesimin për përballje kundër Serbisë.

Autori bashkëshoqëron realen duke krijuar një univers të fuqishëm historik në traditën e rrëfimit, ku thithë vorbulla magjike e ndërthurjes në stil monografik të kompletuar e dokumente arkivore si fakte bindëse për lexuesin e tij.

Krijimi rindërton realitetin në prezantim, formë dhe strukturë brenda sistemit historiko- letrarë ku e gjithë lënda ingranohet dhe dedikohet botës së brendshme të ekspozimit dhe ndërtimit të rrëfimit në këtë libër.

Në shtrirjen e rrafshit historik autori e sjell këtë libër monografik në simbiozë me argumentet e qëndrimet pa kompromis, ndaj komunikon drejtpërdrejtë me lexuesin dhe kërkon mirënjohjen e brezave për këtë studim kaq fin të figurës Aqif Blytës.

I urojmë z. Ismet Azizi dhe krijimtarisë së tij historike shumë dritë dhe reflektim, dhe, sa më ndjeshëm për lexuesin duke vazhduar më tej me kultivimin e artit historiko- letrarë.

Udhë të mbarë librit.

Prenda SEJDIA

“Kthimi i misionarit”, dokumentari që hedh dritë mbi historinë

Në ambientet e hotel “Rozafa”, në qytetin e Shkodrës, me datë 20.06.2021 u përurua dokumentari “Kthimi i misionarit”, prodhim i studio “Valbona”. Promovime të tilla janë të rralla, duke qenë se puna për realizimin e tyre paraqet vështirësi të mëdha, por edhe për faktin e keq edukimit të teleshikuesve me prodhim mediatik, që i ngjan një fluskë sapuni, rendje pas famës së shpejtë apo trillimit të shfrenuar.

Të mos harrojmë se rëndësia e një prodhimi televiziv si dokumentari qëndron në faktin se, ai kërkon të sjellë fakte të reja, ndihmon historinë atje ku ajo ka ngecur, si dhe tërheq vëmendjen mbi personazhe dhe ngjarje të lëna në harresë.

“Kthimi i misionarit” është një dokumentar mjaft interesant, i punuar me shumë përgjegjësi dhe dashuri nga gazetari dhe operatori Mhill Vata.

Ngjarjet nisin të rrëfohen në vitin 1942 e deri në ditët tona. Ato zhvillohen në 3 linja kryesore:

Së pari: Odiseja e largimeve të familjes së Nol Pjetrës fillimisht nga Thethi drejt Gucisë, në kohën kur Nushi, i cili do të jetë dhe personazhi kryesor i dokumentarit, ishte vetëm 2 vjeç. E më tej, gjithë rrugëtimi i stërmundueshëm drejt Kosovës, Italisë, New York-ut.

Së dyti: Jeta dhe veprimtaria e klerikut të njohur dukagjinas At Daniel Gjeçaj.

Së treti: Ndërtimi dhe restaurimi i kishës së Thethit, falë ndihmës së diasporës në SHBA.

Por cilat janë disa nga vlerat e dokumentarit “Kthimi i misionarit”?


Trajton një temë që pak ose aspak është lakuar në media. Përmes fakteve hedh dritë në historinë e largimit të shqiptarëve gjatë monizmit, peripecitë e pafundme për të mbërritur në Amerikë duke e realizuar këtë në një plan individual: largimin e Nush Gjellës. Dokumentari ka dëshmi të gjalla, të siguruar nga Radio Vatikani, gjë për të cilën, autori Mhill Vata ka falënderuar drejtorin e kësaj radioje dhe ish mësuesen e nderuar Ana Luka. Gjithashtu ky prodhim televiziv ka materiale filmike që mbeten unikale dhe do zgjojnë nostalgjinë, pasi do të shihni të afërmit tuaj që sot ndoshta nuk jetojnë më. “Kthimi i misionarit” na jep mundësinë të kuptojmë se sa e fortë është dashuria për vendlindjen, dhe sa mirë përcil-



Nush Gjellaj me gazetaren Kozeta Bruçi



Mhill Vata, autori i dokumentarit, me gazetaren Kozeta Bruçi



let ajo nga prindërit, përderisa një 2 vjeçar si Nushi nuk do ta tjetërsonte Amerika, por do e mbante kokën pas për t'i ndihmuar bashkëfshatarët e tij në Thethin e mahnitshëm, krenar, atje, mes Alpeve shqiptare.

Dokumentari është një promovim i jashtëzakonshëm i natyrës shqiptare. Peizazhet të lënë pa mend. Vlerat e tjera do t'i kuptoni duke e ndjekur këtë dokumentar.

Disa te dhëna për autorët e dokumentarit:

Skenari dhe regjia: Mhill Vata
Konsulent: Martin Shkafja
Narrator: Arben Derhemi
Miksazhi: Ermal Bardhi
Montazhi: Eliseo Vata
Studio Valbona-Shkodër

Kush është gazetari Mhill Vata?

Mhill Vata është lindur në Theth. Ka punuar që nga viti 2007 në TVSH. Bashkëpunimet më të mira në realizimin e dokumentarëve i ka pasur me: Tefta Radin, Pluton Vasin, Arben Derhem, Ermal Bardhin, e të tjerë. Vijn bashkëpunimet me këtë televizion kombëtar, mjaft të njohur sidomos në prodhimin e dokumentarëve. Ka përfunduar studimet në Fakultetin “Gjuhë-Letërsi” në Shkodër. Ka 11 vite që ka ngritur Studio Valbona. Ka realizuar mbi 30 dokumentarë kryesisht në: Pukë, Shkodër, Malësi e Madhe, e të tjerë. të cilat i gjeni edhe në youtube në faqen e Studio Valbona.

Pasion i tij më i madh është gjurmimin dhe studimi i dhisë së egër, dhe pas një pune të stërmundueshme, por të realizuar me shumë pasion ka realizuar edhe një dokumentar për të duke i vendosur titullin “Mbretëresha e Alpeve”. Sot ai paraqitet përpara jush me dokumentarin “Kthimi i misionarit”. Po, për cilin kthim bëhet fjalë? Këtë do ta zbuloni duke e ndjekur atë.

Autori Mhill Vata ka falënderuar shoqatën kulturore artistike “Treva e Dukagjinit” për organizimin e kësaj veprimtarie.

Dokumentari do të shfaqet fillimisht në TVSH, ku dhe Mhill Vata vijon bashkëpunimet.

Përgatiti:
Kozeta Bruçi

XHUBLETA - VESHJE ILIRO-PELLAZGE QË RUHET ENDE NË DITËT TONA

Xhubleta është një veshje tipike e grave në Shqipërinë Veriore, në Malësinë e Madhe, Rugovë, Dukagjin dhe trevat shqiptare në Malin e Zi. Xhubleta është një fund në trajtë këmbane, dhe me vjën e valëzuar përfundi. Përbëhet nga një numër i madh copash e rripash të ngushtë shajaku, të vënë horizontalisht dhe të ndërthurur me breza gajtanësh. Mbahet e varur në supe me dy rripa të gjërë dhe vazhdon me pjesët përbërëse me një lloje jeleku (të ngjeshur pas trupit) që bën edhe lidhjen e vetë pjesës kryesore të xhubletës me krahësat. Pjesë të tjera të kostumit me xhubletë janë: kraholine, xhoka, kërdhokla, paraniku, kallmat e shputat, etj.

Xhubleta është një veshje e punuar nga shajaku (zhguni) në katër liq, e zbukuruar me fije spiku të zi e me një formë kambane e valëzuar, sidomos pjesa e prapme e saj. Me gjatësinë deri nën gju dhe me pjesët e tjera të veshjes deri te koka me rubën (shaminë) e mëndafshit (mnashit), me krahoca të vendosur lirshëm, trupi i malësore merr formën e një maje bjeshke që aq bukur ngjishet për truallin malësor, duke krijuar një qëndrim sa madhor, aq edhe krenar. Te xhubleta janë përdorur ari, argjendi, mëndafshi, apo kadifja vishnje që njihet në të gjithë Evropën si veshje vetëm e aristokratëve.

Qendrat e banuara në zonën e Alpeve Shqiptare, si një qendër e hershme e banuar ka ruajtur dhe trashëguar kulturën e saj në breza, në përputhje me kushtet historike, ekonomike dhe natyrore të saj. Një nga karakteristikat e kulturës materiale të kësaj zone është xhubleta, e cila përfaqëson një nga kostumet më interesante të grave në të gjithë Ballkanin dhe në brigjet e Mesdheut. Shumë studiues të huaj e vendas e shikojnë prejardhjen e xhubletës të periudhës së qytetërimit Kreto – Mikeanas, pra ajo është dëshmitare e një qytetërimi të lashtë mesdhetar, pasi vjen nga më shumë se 4000 vjet histori.

Xhubleta është tip i veçantë dhe shumë interesant për gra, i cili nuk ngjan me ndonjë veshje tjetër të kohës së re në vendet e Evropës Juglindore. Ajo ka strukturë të pasur artistike. Forma e papërsëritshme, ngjyrat, ornamentet dhe stili i zbukuruar i japin asaj karakteristika dalluese nga veshjet tjera tradicionale për gra. Në shekullin e XVIII, xhubleta përbëhej nga shumë ngjyra, por ato që na kanë mbërritur në ditët e sotme janë: të zeza për gratë dhe bardhë e zi për vajzat. Tek kostumi me xhubletë bën përshtypje harmonizimi i veçantë i strukturës tipologjike.

Xhubleta është me prejardhje të lashtë që nga stidues të ndryshëm konsiderohet të jetë mbi 4 mijë vjeçare. Paraqet ngjashmeri me veshjen e disa figurinave neolitike të gjetura në disa vise të mesdheut, që i përkasin mijëvjeçarit të dytë p.e.s dhe lidhen me qytetërimet e vjetra mesdhetare. Xhubleta është trashëgimi e qartë

e kultures sonë ilirjane ku vetëm nëpërmjet saj ne paraqesim historinë e humbur të kombit tonë që malsorët tanë e përcollen deri në ditët tona. Xhubleta është një veshje e cila jep identitetin e kombit shqiptar, nëpërmjet motiveve, ku emblema më e dukshme për te gjitha është shqiponja, por ka edhe simbolika të tjera tipike ilire. Në misterin e xhubletës janë një seri simbolesh ku paraqesin lidhjet me fenë katolike, besimin te zoti, dashurinë dhe bukurinë e femres malësore.

Xhubleta është punuar nga leshi i deleve, nga fijet e "tymnit" dhe "init", të cilat lënueren (l'nueren), tirren në bosht,



thuren në formë pëlhurë në katër liq në avlemend, shkallen me shkaltore, priten dhe më pas qepen polat sëbashku, duke bërë formën tipike në formë të këmborës. Të gjitha këto punë i bëheshin nga gratë e malësisë, si një "zanat" që duhet ta zotëronin të gjitha gratë e shtëpisë. Ky material quhet "tirk", apo faza praprake (skeleti fillestar) e zhubletës. "Xhubleta" e punuar nga tirk zbukurohet me fije spiku të zi. "Spiku" punohet prej "leshit të zgjatur" (tymnit). Bashka në fillim lahet, pastaj shprishet me dorë, ndahet: tymni, lenuret me gërhanë dhe tiritet i hollë me "bosht" "n'furkë". Më pas "dredhet" po ashtu "n'bosht" dhe bëhet 16 fish (16 fije leshi që bëhen bishtalec, thuren si kavo), duke u dredhë të gjitha fijet së bashku, për t'u bërë gati për qepje me gjilpërë. Dredhja e spikut është bërë në veglën adekuate ku punohet. Ky quhet "koshi i spikut" dhe ka "8 kalema" ku është i mbështjellë peri. Xhubleta përbëhet nga "ivat", që nga ana e përfundme kanë "tirk, spiku, rru-

azat, coha e terrtili". Xhubleta përbëhet nga gjithsej 31 pjesë "iva" dhe "spiku". Fundi i xhubletës punohet nga leshi (që është i ngjyrës së bardhë në Malësinë e Madhe dhe prej ngjyrës së zezë në krahinat e tjera që pas vdekjes së Skënderbeut dhe në përkujtim të humbjes së tij), prej katër liqsh, që quhet me emrin "t'pramte e xhubletës". Iva e xhubletës zbukurohet me rruaza të zeza, më të gjata e të vogla, në motive floreale, "n'lula". "Iva e xhubletës me terrtil e rruaza – e pëzier". Në kohë të ndryshme, janë përdorur edhe "laxhuhere"-xixa që kanë shërbyer në formimin e simbolikave të ndryshme

Por, pas kësaj periudhe, qeveria komuniste e ndaloi përdorimin e saj në emër të "emancipimit" të grave dhe vajzave, prandaj mund të thuhet se xhubleta ka rreth 70 vjet që nuk prodhohet më. Kjo gjë ka sjellë në "këputjen" e zinxhirit të trashëgimisë së traditës së prodhimit dhe të përdorimit të kësaj veshje karakteristike. Ndërprerja e zinxhirit të bërjes së xhubletës, është shoqëruar me "humbjen" e njohrive për hallkat e prodhimit të saj, pra mnd të themi se sot, numri i grave (të moashuara) që njohin procesin e prodhimit (me të gjitha hallkat e saj), numërohen me gishtat e dorës.

Pas një periudhe të errët për xhubletën, ku as nuk u prodhua, as nuk u studiuua, as nuk u përdor, as nuk u ruajt si duhet, tashmë ka ardhur një peridhë tjetër: ka rënë alarmi që këtë pasuri të mos e humbim. Ndaj edhe fillimisht duhet të shfrytëzohet të gjithë "njohurinë e gjallë" që kemi në vend: gratë që jetojnë akoma dhe që kanë njohuritë e duhura për xhubletën: për mënyrën e prodhimit të saj. Xhubleta është një veshje unike, e bukur dhe fisnike, një veshje unike e femrave iliro-shqiptare: tek kjo veshje bashkëjetojnë të mishëruara në një: bukuria, veçansia, trashigimia, historia, nostalgjia dhe njëkohësisht pasuria e paçmuar e kulturës sonë.

Tashmë, njerëzit janë në luftë me haresën në lidhje me xhubletën, pasi kjo është një veshje mijëra-vjeçare që ndër shekuj gjeti skutën e saj të mbijetesës, në veriun e Shqipërisë në disa zona të veçanta të saj. Te malësorët, kjo veshje u ruajt më gjatë e më mirë se në asnjë trevë tjetër të truallit iliro-shqiptar, dhe trashigimia e saj të paktën reth katërmijë-vjeçare. Kjo veshje është ruajtur me besnikësi dhe në mënyrë natyrale nga stërgjyshet, gjyshet e nënat tona nga njëri brez në tjetrin. Xhubleta u ruajt jo vetëm si veshje me vlera të papersëritshme të traditës popullore shumëshekullore, por edhe si veshje në të cilën pasqyroheshin apo shkruheshin historitë e jetës, të zhvillimit, të civilizimit, bestynitë apo besimi, që manifestoheshin në periudhat e caktuara të zhvillimit të zonës.

Përveç dijeve dhe angazhimit në bërjen e xhubletës, forcën e gruas malësore në mbajtjen në trup të një veshje të rëndë (xhubleta origjinale e gruas peshon nga 17 deri në 23 kg), gratë e malësisë kanë ditur edhe ta ruajnë siç duhet. Gratë malësore e kanë ruajtur xhubletën në arkën e teshave (rrobave) të plosur mire dhe në mes të saj vendosej një fletë duhani, kryesisht për ta ruajtur nga brisa (tenja). Poashtu, aty në arkën ku ruhej xhubleta dhe rrobat e tjera të gruas, ajo vendosje edhe frutin e ftoit, i cili u jepte atyre një aromë mjaft të mirë.

Si çdo trashigimi e kulturës, jetës, zhvillimit e civilizimit tonë, edhe trashigimia etnografike e xhubletës ka historinë e saj. Trashigimia e xhubletës permban një histori të pasur jo vetëm të etnografisë e civilizimit, por mbi të gjitha ajo trashigimi

për zbukurim të veshjes.

Në këtë veshje bie në sy forma e xhubletës, krejt e veçantë nga çdo veshje tjetër, mënyra e zbukurimit të pjesëve të saja me motive dhe ngjyra të plota, por shumë të zgjedhura; si ngjyra e zezë, çiklamin, vjollcë ose blu. Kjo veshje është mbajtur në të gjitha malësitë e Alpeve të Shqipërisë përfshirë edhe pjesën e alpeve në Malin e Zi. Xhubleta përfaqëson veshjen më të hershme në Shqipëri dhe në Ballkan. Ajo sjell mesazhet e qytetërimit ilir në kulturën popullore shqiptare.

Si veshje e përdorimit të përditshëm në malësitë e Alpeve Shqiptare, xhubleta erdhi deri në ditët tona, duke kaluar në një rrugë plot vështirësi. Një periudhë për tu shënuar është ajo e viteve '60 të shekullit të kaluar, ku sistemi dhe politika, bënë gjithë përpjekjet e tyre për të paraqitur xhubletën si një "mbeturinë", si një veshje "arkaike" dhe nxitën shumë njerëzit që të mos e përdorin më atë. Një justifikim tjerët i regjimit, ishte

gon elemnt të pakontestueshëm të autoktonisë iliro-shqiptare në trojet etnike e më gjërë. Duke pasur këtë histori të pasur trashigimie, xhubleta ka terhequr vemendjen e jo pak studiuesve, etnografëve, arkeologëve, historianëve, albanologëve e ilirologëve të huaj e vendas, të cilët kanë shkruar për xhubletën, historinë, bukurinë, figurat, simbolet e mesazhet që trashigon kjo veshje karakteristike e zonës së *Alpeve shqiptare*.

Albanologu dhe Ilirologu i njohur kroat Aleksander Stpçević në zbulimet dhe studimet e tij shkencore, për veshjen e lashtë të grave iliro-shqiptare, pra për xhubletën, ka theksuar: "Gratë Ilire vishnin gjithashtu një tip fustani që ishte i prerë në brez kështu, që pjesa e sipërme ishte e pëlqyer për trupin, ndërsa pjesa e poshtme ishte e rrudhur dhe kishte formën e kumbonës. Këtë formë rrobash e mbanin hyjneshat lokale: Diana, Nimfat, etj. Xhubleta gjendet edhe në monumentet nga epoka romake si dhe gratë valltare, të paraqitura në urnat japode nga Ribiqi, që i përket shekullit V-IV para Krishtit. Me rroba të tilla është veshur hyjnesha Diana, që është paraqitur në monedhat e mbretit ilir Ballaeus (shekulli i II para Krishtit).

Kjo veshje në formë këmbane apo kumbone e qendrisur mrekullisht prej qindra figurash e bojnash, është pa dyshim xhubleta e grave iliro-shqiptare (kryesisht malësore) e ruajtur mrekullisht deri në ditë e sotme në Malësinë e Madhe e më gjërë. Xhubleta mendohet se ka qenë e perhapur edhe te paraardhësit e Ilirëve, Pellazgët. Ilirët si një ndër "fiset" më dinjitoze e trashiguan këtë veshje të fisme për shekuj deri në ditët e sotme. Xhubleta u ruajt me "fanatizëm" dhe u pasurua me motive nga më magjepsset me karakter natyror, hyjnor e deri fisnor. Ndër fiset ilire të Labeatëve dhe Dardanëve e ka pasur dhe e ka konakun e saj Xhubleta edhe sot. Pra kryesisht në trevat Veriore të Shqipërisë Etnike. Si simbol i kesaj veshje të fisme, me prejardhje (të pakten mbi katërmijëvjeçare), nga koha pellazge e deri sot, në Kretë të Greqisë, ruhet një sulpturë që ngjason me xhubletën. Vlenë të cilësohet se veshja e grave me xhubletë "shoqërohej" edhe me veshje të tjera si xhoka, këmisha, postava, çorapet, rubat (shamiat) e kokes të grave që janë trashigimi ilire. Madje edhe shamiat e bardha që shpesh lidheshin si kapica mbi kokë, janë trashigimi ilire, që kishin për qëllim të ruanin floket nga pluhurat, por edhe të mos fshihnin hiret e fetyres së grave Ilire.

Hershmërinë e xhubletës si veshje ndër femrat iliro-shqiptare e vertetojnë edhe vetë figurat dhe simbolet e qendrisura në xhubletë. E tregojnë, pasi ato figura e simbole u perkasin edhe bestynive dhe besimeve pagane, të cilat ndër ilirë kanë ekzistuar të pakten qindra vite para besimeve monoteiste, kristiane e tjerë. Ndër më të njohurit janë simbolet që i kushtohen Diellit, Hënës, yjeve, Gjarprit shqiponjës (me dy krena), dragoit e figura të tjera që trashigojnë simbole jete e historie e deri simboli i kryqit "thyer" (svastikës), që në gjuhën sanskritishte "svast" që do të thotë shëndet, mirësi dhe



gëzim. Ndërsa J. Dechelette, svastikën e ka karakterizuar si simbol "Dielli në lëvizje".

Për xhubletën, veshjen karakteristike tradicionale të grave iliro-shqiptare të veriut shkruan edhe Franc Nopça -studiuues dhe albanolog (ish konsulli i pergjithshëm i Austrohungarisë në Shkodër) i cili ka qenë edhe "gjurmuës" i apasionuar i etnografisë në trevat veriore të Shqipërisë. Më 1910 Franc Nopça, pati konstatuar se disa forma të veshjes popullore shqiptare vijnë drejtpërdrejt nga veshja që ka qenë në përdorim në këtë hapësirë nga koha parahistorike. Këtu në rend të parë është fjala për tipin e fustanellës së mbledhur në formë të kumbonës (ziles), të quajtur xhubletë, e cila është pasqyruar në shumë monumente ilire të kohës antike, dhe e pandryshuar është ruajtur deri në ditët tona në krahinat kodrinore të Shqipërisë Veriore, mandej në zonat e fisit të Kelmendasve në Kosovë dhe tek shqiptarët në Mal të Zi. Xhubleta në pikpamje kostumografike, është shumë interesante, për arsye se perkon kryekëput me veshjet në formë fundi, të njohura nga disa terrakota të zbuluara në Kliçevac të Bosnjes dhe me objekte të tjera të ngjashme të gjetura në Mikenë dhe në Kretë (Greqi). Kjo terrakotë tregon se në të gjitha këto raste, kemi të bëjmë siç e theksojnë Hoernes, Wide, Evans dhe Vasits, me një veshje në formë këmbane, të njohur që nga koha e



lashtë, mijëvjeçari i dytë para Krishtit."

Xhubleta e Malësisë sipas studiuesve të mirfilltë të etnologjisë, paraqet një ndër veshjet më të vjetra të Europës, si mbetje e një qytetrimi të lashtë mesdhetar e ruajtur në shekuj në mënyrë besnike dhe autentike në traditën e veshjes popullore shqiptare. Veshje me zanafillë të lashtë është xhubleta e që është mbajtur në Malësinë e Madhe dhe më gjërë. Kështu ka ardhur dhe dalmatika, një këmishë e gjatë që në të njëjten formë e prerje është ruajtur edhe ndër shqiptarë. Një

studiuuese dhe mike e shqiptarëve dhe malësorëve, që ka vizituar trojet tona në fundin e viteve të shekullit të XIX dhe fillimit e atij të XX, shkruante për veshjen e malësoreve me xhubletë (vajzave dhe grave): Vajzat vishen me një rrobë të trashë, të ngrirë prej leshi të bardhë me shirita horizontal me ngjyrë të zezë. Fundi vjen e bashkohet me pjesën e sipërme të rrobës, e cila është e kapur anash. Çorapet e gjata të thurura me figura të bëra me fantazi, kuq e zi, apo baardhë e zi. Gratë e martuara mbajnë veshur një fund në formë këmbane, prej leshi të rëndë e të ngrirë, me shirita në një ngjyrë kërmizi të shuar (të lyera vetë) apo ngjyrë të purpurt. Xhubletën e çikave, ose xhubletën e bardhë, poetja dhe koleksionistja shqiptare Luljeta Dano e cilëson si një veshje e jashtëzakonshme, mrekullisht të bukur, për cilësitë e punimit dhe të qëndrueshmërisë, që dallohet nga simbolet e fertilitetit. Është një nga kopjet më të rralla, sepse xhubletat e bardha janë vërtet të rralla. Vajza e vishte deri në momentin që marotohej. Studuesja Edith Durham në shkrijet e saj vleron edhe rolin e këtyre grave ("të xhubletës") malësoreve në jetën e perditshme kur shkruan: "Një grua në Malësi me gjithë punën e rëndë që është detyruar të bëjë nga shumë anë, është më e lirë sesa gratë në Shkodër. Ajo u fletë lirisht burrave, shpesh është e zgjuar dhe e shkathët, mund t'i kerkojnë mendim e ta dëgjojnë... kam parë gjithashtu gra që kanë nderhyrë për të ndaluar një grindje, por kur preket nderi i familjes edhe ato janë të shqetësuara ashtu si dhe burrat që të merret gjaku..."

Raca shqiptare, duke qenë kaq e lashtë, ka ruajtur mrekullisht shumë prej trashigimisë së hershme kulturore të saj. Popullsia e malësive shqiptare është perçuesja më besnike e qytetimit të saj të lashtë, por nuk është një race inferiore. Cilësitë fizike dhe morale e bëjnë atë një prej racave më të bukura dhe më të pasura të Lindjes dhe të Europës. Përveç ruajtjes të xhubletave në shtëpia ngatë fisnike të Malësisë Madhe e më gjërë, ajo është ruajtur në muzetë lokale, që nga muzeu i Shkodrës e deri te muzeu etnografik i Malësisë i ndërtuar, themeluar e mbajtur në Lekaj të Tuzit (nën Malin e Zi) nga shqiptari patriot trup-vogël e zemër-madh z.Shtjefen Ivezaj me bashkëshorten e tij Gjysten (Muze për të cilin ka sakrifikuar shtëpinë e tij) e tjerë e deri në muzeun kombëtar në Tiranë. Në fondet Etnografike të Institutit të Kulturës Popullore janë ruajtur rreth 40 xhubleta, të futura në koleksionet e muzeut që nga viti 1948 e këtej. Ajo më e hershmja vjen

nga Hoti i Malësisë së Madhe; një vit më vonë është blerë një xhubletë vajzash e pasuruar ndër vite edhe me blerje të tjera xhubletash.

Xhubleta ruhen edhe në disa muze, si: në Muzeun Etnografikë të Beogradit, të Sarajevës e të Zagrebit, në Muzeun e Kitzsees në Austri. Në Muzeun e famshëm të njeriut në Paris, ku ka disa xhubleta, ndër të cilat edhe ndonjë më të hershme se ato të koleksioneve tona, të blerë që në vitet tridhjetë (të shekullit të XX). Në muzeun e Njeriut në Paris, xhubleta është e zbukuruar me disa iva ose rrogzina cohe vjollcë, vishnje ose të kuqe të alternuara me ivat e zeza dhe në pajtim me të shkojnë edhe zbukurimet e përparjes, të këdhokllës e të xhokës (sidomos thekët e supave). Kurse një xhubletë e paraqitur e Max Tilkes mbi kostumet, është ngjyrë portokalli me të bardhë. Pra siç shihet Xhubleta ka terhequr edhe vemendjen e disa muzeve të shteteve europiane, të cilat kanë siguruar dhe ekspozuar xhubleta (dhe pjesë të kostumit saj), në ambientet e muzeve të tyre. Nga ana tjetër kanë qënë një sërë ekspertësh de vizitorësh të huaj, të cilët kanë marrë xhubletat në vendin tonë dhe i kanë bërë pjesë të koleksionit të tyre familjar, në ShBA, Gjermani, Austri, Holandë, e vende të tjera.

Xhubleta nga etnografët e kostumografët konstatohet se është një nga veshjet më të veçanta, më komplekse dhe më të veshtirat në punim. Në punimin e xhubletës kerkohet profesionalizem prefekt, njohje e traditës historike e pa deformuar, saktësi, durim, fantazi, por edhe novatorizem në kombinimin e të vjetrës së tashiguar me të rejat që imponon koha. Xhubletën e kanë punuar mrekullisht vetëm mjeshtrë duararta. Veçantitë e xhubletës, si një kostum krejt i veçantë, kanë terhequr vemendjen me prerjen e jashtëzakonshme të saj, që nuk gjen paralele me asnjë nga tipet e tjera ekzistuese të veshjeve për grate në Shqipëri, në Ballkan e më gjërë. Ajo përbehet nga një numër çuditërisht i madh copash e rripash shajaku e cohe dhe nga një sasi e konsierueshme spiku të leshtë. Konkretisht duheshin afërsisht 25 deri në 30 copa me forma të ndryshme, por duheshin gjithashtu dhjetra metra spiku të përgatitur në shtëpi me një teknologji mjaft primitive, duheshin po ashtu penjë të fortë leshi për qepjen e saj. Konfeksionimi i saj është padyshim një provë e vertet bravura (zotësie), sepse duhet njohuri e shkathhtësi e veçantë për t'i montuar së bashku gjithë ato copa e copëza, aq më tepër që, duke qenë të trasha, ka veshtirsi të manovrohen për t'u bashkuar njëra me tjetren, sidomos kur ky bashkim nuk bëhet midis gjatësish të barabarta, si ndodh zakonisht. Kështu një rrogzinë, të themi 200 cm, duhet bashkuar me një 180 cm, ose në rastin e xhokës, një copë shajaku, që formonte pjesën e poshtme të saj, duhej mbledhur në formë palash të dendura, punë aspak e thjeshtë kjo. Duhej pra një teknikë shumë e nderlikuar dhe e vështirë për të qepur pjesët e ndryshme të kostumit me xhubletë. Kostumi me xhubletë ka një sitem shumë të veçantë zbukurues, ku perdoren elemente shumë të lashta zbukurimi, si thekët apo mbivendosja e copave, shumë spik, pastaj edhe

Disa të dhëna mbi alergjinë

Alergjia vjen nga fjala greke “allos”, që do thotë tjetër (detinim), dhe “ergon” reagim ... që do thotë ndryshim reaktiviteti, pra tjetër reagim. Alergjia është një fenomen i ekzagjeruar patologjik i përgjigjes imunitare (forcave mbrojtëse) në veçanti nga reaksionit inflamator përball një agjenti (anti-gen) përgjithësisht jashtë organizmit. Flitet në mënyre më precize në rastin e alergjisë, pra është fjala për formën e hiper-ndjeshmërisë. Ekziston paraprë familjare ose flitet në këtë rast për terren “atopic” Pra flitet për faktor rëndues tek disa persona në funksion të zhvillimit alergjik. Alergjia në mënyre popullore paraqitet si një sëmundje me shumë aspekte. Nga fakti se një alergji primare lajmëron shpesh për një terren alergjik të përgjithshme.

Nga ana epidemiologjike mund të themi se janë rritur shumë rastet në vendet e industrializuara duke u bërë një fenomen vërtete social emergjent me një shpejtësi të papare. Sot ne bote vuajnë nga astma dhe sëmundjet alergjike rreth 300 milion njerëz, dhe duket se ka lidhje të forte me

urbanizimin dhe stilin modern të jetës. Kështu në Evropën perëndimore astma ka një shpeshësi midis 15-20% te popullatës dhe çfarë është më e rëndësishmja 1 ne 4 fëmijë vuan nga astma. Në një studim në bashkëpunim ndërkombëtar ku u përfshin dhe fëmijët e grup moshave 13-14 vjeç të Tiranës, brenda 5-vjetësh pati një rritje nga 1.6 ne 3.6%. Gjë që ven theksin se me ndryshimin e stilit të jetesës, me grumbullimet e mëdha në kryeqytet dhe në vitet e ardhshme do të përballemi me rritje të këtyre rasteve Në vitin 1980 vuante 10% e popullsisë, në vitin 1999 kjo shifër arriti në 30 % dhe parashikohet që në vitin 2025 të behet më alarmante duke arritur në 50% në e vendet e industrializuara të hemisferës së Veriut.

Manifestimi klinik: Fillon me lotim, me kullim / me rrjedhje hundës, kolle ngacmuese. Me ardhjen e stinës së pranverës, fillimi i lulëzimit, polenizimit të bimëve, sipas të dhënave italiane 1 ne 3 veta llogariten me alergji polenesh, që shpesh u mbi-vendoset dhe alergjia e gramineve, akarieve (këpushat) ose dhe ajo ushqimore duke shumëfishuar shqetësi-

met.

Imunologu Attiglio Specioni shpjegon: Alergjia nuk është sëmundje, por sinjal i organizmit se është në vështirësi .

Si mund ta ndihmojmë organizmin, duke përfunduar mbrojtjen natyrale të tij?!

Pesë faktorë që rrezikojnë dhe që duhet të kemi vëmendjen e duhur janë:

- Akariet (këpushat) që përmbahen në pluhurin e shtëpisë me mijëra allergen.

- Lëkura e maces ka një protein alergjike.

- Polenet janë përgjegjës kryesorë të alergjisë.

- Disa insekte prodhojnë lende alergjike.

- Shumë ushqime përmbajnë lende alergjizuese.

Këto allergen mbeten përgjegjës për lënde alergjike që janë prezent në ambiente që jetojmë përditë .

Dhoma ku qëndrojmë, garazh, lavanderi, kaldajë. Jashtëqitjet, pështyma dhe qelizat e vdekura që deskuamohen të specieve të ndryshme përmbajnë blatelagermania, blat-orientalis që janë potencialisht alergjike, ka vende dhe ambiente

rueaza, pafta të vogla filigrane, shirita e fije ari etj. Edhe përbrenda pjesëve përbërëse të këtij kostumi; xhubletës, kërdhoklës, përparjes, xhokës etj.- bie në sy një pështatje e kërkuar e motiveve të zbukurimit nga njëra pjesë në tjetrën.

Gjithashtu te xhubleta vihen re disa tipare arkaike, për shembull: ashtu si në veshjet homerike, xhubleta nuk është një veshje që bie lirshëm në trup, por rri e ngrirë dhe pa shumë perkulje. Pastaj perdorimi i thekëve të gjatë për zbukurim tek supet e xhokës dhe te pjesa e poshtme e përparjes ka gjithashtu karakter arkaik. Edhe kërdhokla duket se është shumë e lashtë. Një dëshmi tjetër kemi tek vargoi i brezit që perdorin gratë malësore, i dëshmuar arkeologjikisht që në prehistori. Xhubleta është dëshmitare e një qytetrimi të lashtë mesdhetar, që i pati paraprirë qytetrimin ilir, në të cilin u integrua, por nuk u asimilua. E strukur në zona relativisht të izoluara e malore, ajo pëshkoi Mesjetën, duke arritur deri në shekullin tonë, duke na sjellë një mesazh mjaft të qartë nga e kaluara e largët.

Xhubleta është punuar nga leshi i deleve, nga fijet e tymnit dhe init, të cilat lënuen-tirren në bosht, thuren në formë pelhure në katër liq në vekë (avlëmend apo tezgjah), shkalen në shkalatore, prehen dhe qepen. Të gjitha këto punë i bënë gruaja malësore. Ky matrial quhet tirk. Xhubleta e punuar nga tirku zbukurrohet me fije spiku të zi. Spiku punohet prej leshi të zgjatur (tymnit). Bashka sëpari lahet, pastaj shprishet me dorë, ndahet tymni, lënuet me gërhanë e tirret i hollë me bosht në furkë. Pastaj dredhet po ashtu në bosht dhe bëhet 16 fish, duke u dredhë të gjitha fijet së bashku, për t'u bërë i gatshëm për qepje me gjylopërë. Dredhja e spikut është bërë në veglen adekuate ku punohet. Ky quhet koshi i spikut dhe ka tetë kalema ku është i mbështjellë peri. Xhubleta përbëhet nga ivat , që nga ana e

përfundme kanë tirk, spiku, rruazat, coha e terrtili. Xhubleta përbëhet nga gjithësit 31 pjesë iva dhe spiku. Fundi i xhubletës punohet nga leshi i ngjyrës së bardhë, prej katër liqsh, që quhet me emrin t'pramtë e



xhubletës. Iva e xhubletës dekorohet me rruaza të galme më të gjata e të vogla, në motive floreale, n'lula. Iva e xhubletës me terrtil e rruaza- e perzier. Në disa forma, ka pasur edhe laxhuhere – në formë rruazash.

Kliti i xhubletës është punuar prej tirkut e spikut, ndërkaq krahët dhe kracat e xhubletës janë punuar nga leshi – tirku. Prehni i xhubletë po ashtu. Në fund greshpet, të punuara nga peni i leshit ngjyrë fice (të kaltër). Shogzat në vend rrypi. Zakonisht në rreshtin e fundit të këmbanës, të kordonit të bardhë, gjithmonë gjen një rresht të tillë që është o gjarpër, o është shumë i ngjashëm me zinxhirin e ADN-së, ose me diçka si fetus, embrion fëmije. Por këto janë çudirat që i përkasin kësaj bote. Gjithashtu është shqiponja me dy kokë, me tipare dragoi dhe shumë herë e gjejmë me flakën që dragoi nxjerr nga

goja.

Vlenë të thuhet se kostumi i xhubletës kishte edhe “paime” të tjera si: rubën e leshit (rubën me thekë), këmishën e pelhurës me grykën e saj, kraholin prej cohe, mallotën (e galme), grykocën (matrial veleduni-kadife), p'shtjellakun, çorapet, këputët, opakët (opinga, opangë), etj. Por i gjithë procesi për punimin e xhubletës është një proces mjaft i komplikuar. Gruaja malësore duhet të ketë një eksperiencë (që më parë transmetohej nga një brez tek tjetri), që ta thurë kokërr për kokërr sythi dhe ta montojë në një mënyrë të tillë që të marrë formën e duhur të kabanës dhe të rrijë në këmbë. Historikisht xhubleta bëhej besnikërisht në vijë familjare dhe çdo vajzë ka mbaratur statusin familjar, farefisnor, etj. Veshja është një *tregues i shkallës së individit në shoqëri, i vendit të fisit në rajon*, ajo përfaqëson gradat e jetës civile-familjare. Në shekullin e XVIII, xhubleta bëhej me shumë ngjyra, por ngjyrat që kanë arritur në ditët e sotme janë me dominacë: të zeza për gratë dhe bardh e zi për vajzat. Xhubleta është nodhta e vetmja veshje që jep identitetin e kombit Shqiptar, nëpërmjet motiveve, ku emblema më e dukshme për te gjitha është shqiponja. Por, në tërësinë e simbolikave të përfshira në misterin e xhubletës janë edhe një seri simbolesh ku paraqesin lidhjet me besimin te zoti, dashurinë dhe bukurinë e femrës malësore, etj.

Studiuesi dhe publicisti i njohur Fahri Xharra, nga Gjakova, në një shkrim të tijë, ndër të tjera shkruan: “Kostumografia jonë të mahnit me vlerën e materialeve të përdorura si ari, argjendi, mëndafshi apo kadifja vishje që njëhej në të gjithë europën si veshje vetëm e aristokratëve por që gjendet në të gjitha objektet tona etnografike. Por më e çuditshme se materialet janë teknikat e punimit që mundësojnë të kemi sot veshje 4000-vjeçare që

ku përqendrohet alargen, d.m.th. lende që mund të shkaktojnë reaksion alergjik te njerëzit e ndjeshëm. Ato ndodhen në kafshe, insekte, bime dhe ushqime. Por duhet të mos harrojmë disa detergjent larës të shtëpisë, të cilët mund të japin probleme.

Në sallone – divanet poltronat, tapetet përmbajnë akarie (këpusha) pluhuri prandaj hapni shpesh dritaret dhe dyert, pakësoni lagështirën që favorizon shtimin e këtyre qenieve mikroskopike, gjëndrat yndyrore të lëkurës maces prodhojnë proteina alergjike që përhapen në ambient .

Kuzhina dhe salla e ngrënies, shumë ushqime në veçanti fruta dhe lëngje, por dhe veza, kustracie dhe qumështi përmbajnë lende që mund të shkaktojnë reaksion alergjik dhe përmbajtje avuluese që ndodhen në disa detergjent (pastrues), për larjen e shtëpisë mund të japin alergji. Në banja /dushe si ambiente me lagështi shumëzohen mykura dhe akarie që mund të shkaktojnë alergji. Rëndësi ka që të ajrosen shpesh këto ambiente, të lahen me ujë të rrjedhshëm, dyshemeja , tapetet mbulesat dhe perdet. Dhoma e gjumit në radhë të pare grumbullohen këpushat /akariet e pluhurit. Për këtë dera dhe dritarja duhet të paktën 1-ore ne dite të hapura. Mbulesat duhet të lahen të paktën në temperature 55 grad C . Pra, vendet dhe objektet ku ndod-

gjenden jo në formë arkaike, por me një sofistikim të frikshëm në kuptimin estetik, kulturor dhe pasuror, duke sjellë antikitetin si një postmodernizëm të pasuruar me figura simbolike”.

Këtë vit, Ministria e Kulturës, në bashkëpunim edhe me institucione, donatorë, struktura lokale, por edhe individë të shquar në njohjen dhe lidhjet me xhubletën, ka përgatitur dosjen për të kërkuar që UNESCO ta shpallë XHUBLETËN, pjesë të trashëgimisë kulturore botërore. Mbetet që gratë e moshuara, që kemi fatin ti kemi akoma në mesin tonë, të nxiten në iniciativa të trajnimit të së paku një grupi të grave dhe të vajzave të interesuara, që synojnë ruajtjen dhe trashëgimin e njohurisë në punimin e xhubletës. Një iniciativë e tillë është një detyrë patriotike, fisnike dhe një homazh për brezat që na e trashëguan këtë perlë të identitetit tonë. Por, nga ana tjetër, mund të konsiderohet edhe si pjesë e iniciativave të biznesit: sot një xhubletë origjinale (e punuar sipas traditës), mund të shitet edhe me 2 mijë euro. Në kushtet e grave dhe të vajzave të zonës së Alpeve të Shqipërisë, kjo përbën një mundësi shumë të mirë për sigurimin e të ardhurave, me punë në shtëpi, ku produkti i duarve të tyre, është një produkt shumë i kërkuar.

Le të shpresojmë që aktorët e ndryshëm: institucionet publike, organizatat joqeveritare, donatorë të ndryshëm, qoftë edhe individë me iniciativa, të bëjnë të mundur që duke shfrytëzuar traditën, duke shfrytëzuar leshin e deleve të vendit, duke vënë në punë mendjen dhe duart e arta të malësoreve tona, të arrijnë të ruajnë, të përtërijnë dhe të trashëgojnë zana-tin e bërjes së xhubletës, duke e rikthyer këtë veshje unike në pjesë të jetës dhe të përditshmërisë së tyre.

Prof. As. Dr. Zef GJETA

hen alergjenet, d.m.th. lendet alergjike janë njerëzit, kafshët, insektet, bime dhe ushqime si dhe disa lende pastruese që avullojnë. Në studio, lepizma sacharina është një insekt, që jeton në letra, libra që shkakton lende potencialisht alergjike.

Kopshti dhe ballkonet, dhe polenet e bimëve mund të behën pjesëmarrëse nga sekrecionet dhe jashtëqitja, krahët, luspat e insekteve të pemëve të kopshtit që varen lulet në vazot e murit. Muaji mars nuk është për të gjithë një stinë e bukur dhe e këndshme. Në ajër, në fakt fillon dhe përhapet polene graminac dhe të bimëve të tjera të shënuara për alergji.

Në Francë jepet alarm ndaj alergjenteve, në pranverë ku u hap një erë e furishme për shamitë e xhepit dhe maskat respiratorë, sepse vëzhgimet aerologjike të favorizuara nga klima, si zgjatja e ditës, rritja e temperaturave, rrezet e diellit, precipitimi e të tjera. Dhe faktor të tilla si bulëzimi, lulëzimi, çelja e pemëve, gamineve të qyteteve dhe ndotja si dhe në fshatra përqendrimi i madhe i poleneve bëjnë alergji sipas ANSES (Alergjia Kombëtare e Sigurisë e Ushqyerje, Ambientit dhe Punës) thekson se, alergji ndaj poleneve prek afër 30% të rriturve dhe 7-20% të fëmijëve.

Sipas të dhënave italiane, 3 milion persona, duke u detyruar të bashkëjetojnë në vështirësi në pjesën dërmuese të vitit (me efektet alergjike). Në ambientet ku ne jetojmë, në fakt ekzistojnë mijëra lende me potencial alergjik, që siç u shpreh me lart janë ushqime, insekte, kafshë shtëpie, që e ndotin ambientin me pluhurin që ngrihet. Megjithatë vetëm disa persona janë alergjike ndaj këtyre lendeve, ndërsa të tjerët nuk kane problem. Alergenet, duket se nuk janë si virusi i varicelës, që nuk i godet të gjithë në të njëjtën mënyrë. Për këtë, sot po ndryshon marrja në ngarkim dhe trajtimi kundër alergjisë. Prej vitesh alergji është konsideruar si një sëmundje që kurohet me ilaçe kundër si antihistaminiket ose kortizoniket. Sot përveç kësaj, studimet tregojnë se ky problem është një sinjal i lëshuar nga organizmi ynë se diçka po e kërcënon. Lotimi, teshtitja, kollat, këto simptoma tregojnë se organizmi është në vështirësi dhe kërkon të mbështetet me diçka. Si një tenxhere me presion që fillon e nxjerr nxehtësi nga valvula – alergji është një lloj SOS që organizmi e fton kur nuk arrin ta durojë lenden, ushqimin, ose solucionin që ndodhet në ambientin ku ai jeton. Po perse trupi e konsideron rrezik një granul poleni ose një domate?! Secilit nga ne, mund ti lind alergji në përgjithësi por rritet memoria për të njohur, d.m.th. bën pjese në ambientin tone dhe nëse tolerohet do të thotë se, është e panjohur për organizmin. Për një të porsalindur një pjate kolimaku e parakohshme me përzierje ushqimesh mund të rezultojë fatale, por pas 12 muajsh ai mund ta toleroj pa problem. Çdo lende e panjohur aktivizon sistemin imunitar mbrojtës, duke i dhënë përgjigje me prodhiminflammatory p.sh. histamin e të tjera. E veçuar gjithçka behet në mënyrë të kontrolluar, si një sensor i ambientit që vlerëson dhe sinjalizon, d.m.th. e kontrollon. Por aftësi të tilla adaptuese pak nga pak humbin kontrollin. Për ta bere organizmin tone më pak të

afte të reagoj dhe të përshtatet ambientit. Stephan Genuiskerkues kanadez shpjegon se lendet ndotëse ulin në mënyrë progresive aftësinë tone të adaptimit. Nuk është rastësi që alergji është më e përha-

(koha e poleneve). Si rrjedhje hundesh të ujshme, skuqje, enjte e kongestion hundesh, skuqje, djegie sysh, lotim, teshtitje, kruajtje e qelizës, hundëve, syve, kolle e thate dhe me kriza natën, ulje e shijes

sidomos në periudhën e poleneve. Trajtimi duhet të fokusohet në tre drejtime: 1- Largimin nga faktorët që shpërthejnë krizën nëse është e mundur dhe për këtë duhet të përcaktohet me prova kutane (në



pur në vendet ku atmosfera është me ndotje më të lart. Emocionet të bëjnë më të prekshëm ndaj alergjenteve.

Që në vitin 2001, Rita Levi Montalcini shënjoj se nervigrowth faktor lende, që u zbulua në vitin 1986 dhe që mori çmimin "Nobel", prodhohet nga organizmi në kushtet e stresit fizik ose psikik si divorci, aksidentet e të tjera. Kjo lende shumëfishon reagimin alergjik te organizmit. Ushqimi luan një rol të rëndësishëm në



alergji. Një diete monotone e çekuilibruar e varfër në fruta pa bilanc, stimulon organizmin që të prodhojë lende inflamtoare. Është kjo mënyrë, në të cilën organizmi ynë sinjalizon se, nuk arrin të përballojë dhe të tolerojë sasinë e madhe të këtyre ushqimeve. Nëse në këto kushte hyjmë në kontakt me një alergjen si poleni, është e mundur të behësh alergjik ndaj tij dhe kështu trupi ynë akuzon duke fajësuar si fajtorë një të keqe të pa qene.

Ftohje apo alergji?

Trajtohet alergji ndaj poleneve nëse janë prezent këto simptoma më tepër se 7-dite ose për një periudhe polenizimi

dhe nuhatjes, vështirësi në frymëmarrje dhe kriza astma. Nëse alergji është një sinjal, është e mundur të interpretohet para së gjithave, duke kërkuar shkaqet që ndërhyjnë dhe të mësohet sistemi imunitar për të modeluar përgjigjen inflamtoare. Homeopathia ka shumë përparësi. Ilaçet nuk janë të privuar nga efektet anësore, si përgjumja dhe helmimi, të bazuara në lenden natyrale. Por dhe të adaptuara për fëmijë ose për grat shtatëzana kur përdoren për kohe të gjate dhe së bashku me ilaçet e tjera kur është nevoja. Zgjedhjet janë të shumta dhe disa minerale janë të dobishme, si suport, zinku, bakri riekulibronjë sistemin mbrojtës imunitar për të ul ose shmangur reaksionin alergjik. Çrregullimet e krijuara nga alergji mund të ulen ose eliminohen duke ndryshuar dietën, rregulli numerik 1 është të ndryshohet realisht ushqyerja. Makarona, buke, prodhime furre mund të hash gjithë ditën, por ekzistojnë miellra të ndryshme alternative, grurë, thekër, misër, elb, tërshërë, po ashtu dhe për qumështin e djathin, që nga bigëtit, lope, dele e dhi. Por dhe qumësht bimorë si soj, bajame e të tjera. Frutat dhe perimet e freskëta me ngjyra dhe të gjalla janë të përdorshme, por në fakt përmbajnë pan-alrgen.

Lende që mësojnë organizmin dhe ndihmojnë për ta konsideruar normal dhe largojnë eksitimin (nxitjen) nga alergjenit. Një zakon i shëndetshëm është që të fillohet ngrënia me zarzavate e vaj ulliri dhe fruta të ndryshme. Zakoni që të mbahet në tavolinë vetëm buke dhe patate të fërguara duhet të ndryshoj. Kur jeni alergjik ndaj poleneve duhet të dish, që duke ngrënë ushqime të caktuar mund të takohesh me një përgjigje alergjike. Një person alergjik ndaj graminacave mund të ketë reaksione më intensive pasi të konsumojë një domate, ky reaksion i kryqëzuar mund të mos takohet kurrë ose rrallë, por kjo duhet të përjashtohet në momentin që nuk tolerohet,

lëkure) dhe me përcaktimin e IgE (imunoglobulina E), në rastin e atopis (alergjis nga akariet e pluhurit të shtëpisë sepse kjo është një alergji e vazhdueshme). Në rastin e alergjisë nga polenet, në stinën e pranverës, duhet të merren masa për hapjen e dritareve dhe ajrosjen e shtëpisë, herët në mëngjes dhe pastaj të mbyllen xhamat. Po ashtu dhe rastet e udhëtimeve në zona e polenizimit duhet të mbyllen xhamat e makinave, duhet të mos dilet në ambiente të gjelbëruara pas orës 10:00 të mëngjesit deri pas dite vone. Në rastin e alergjive në ambientin e punës, alergji profesionale, duhet të ndërrohet vendi i punës, ose procesi i punës; duhet të shmangen infeksionet virale, si p.sh vaksinimi kundër gripit. Me ane të mjekimit të vatrave inflamtoare dhe njëkohësisht të zhvillohen ushtrime të përshtatshme pa kaluar në kriza astma, dhe të ruheni ndaj disa medikamenteve e ushqimeve që nxisin për alergji.

2- Mjekimi me ilaçe (medikamentoz), duhet të behet nga mjeku specialist alergolog, pas vendosjes së diagnozës. Kjo përfshin broncho –dilatoret simpaticomimetit, në forme pompe (Ventolin), me 2-pompime njëra pas tjetrës. Dhe nëse kriza nuk qetësohet brenda 10-15 min. përsëritet kjo procedure. Dhe brenda 2-3 orës nëse nuk qetësohet duhet të përdoret kortizonik me injeksion 4-6 mg për kg/peshe, deri tek përdorimi i adrenalinës subcutan sipas këshillave të mjekut.

3- Imuno terapia specifike, pasi përcaktohet alergjeni shkaktar, IgE specifik, vendoset fillimi i imuno-terapis, pra vaksinimi, gjë e cila parandalon shfaqjen e astmës.

Mos nënvlerësoni asnjë shfaqje si zënie-fryme, kriza kolle, ngacmime të ndryshme alergjike, por menjëherë konsultohuni me mjekun tuaj ose tek specialist alergologji.

Një udhëtim i bukur në rrafshin e Dukagjinit

- Reportazh -

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Peje, si çdo vit, edhe këtë vit, megjithëse ende nuk është larguar pandemia, ajo mori guxim dhe organizoi Manifestimin-2021, me temë patriotike: "Sakrifica Kombëtare për Liri e Pavarësi", me datën 12 qershor 2021, në Rugovë-Rugova Kamp. Në këtë veprimtari morën pjesë nga të gjitha trevat veriore shqiptare, që nga Mali i Zi e deri në Kosovën Lindore, dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", gjithsejtë rreth 50 pjesëmarrës.

Grupi përfaqësues i Shoqatës, i përberë nga Ndue Sanaj, Lulash Brigja, Lulash Gjeloşi e inxhinieri Vuksan Vatnikaj, në ditën e 22 vjetorit të çlirimit të Kosovës, kafën e mëngjesit u ndal ta pi në Gjakovë, te hotel "Pashtriku", me profesor doktor Tahir Bexhani, me një studiues e botues, një nder veprimtarët e rëndësishëm për çështjen kombëtare, për çlirimin e Kosovës. Ai, megjithëse ishte i bërë operacioni doli e na takoi, ndenjëm nga ora 10.00 deri në orën 11.00, me të cilin biseduam për lidhjen e vjetër Shkodër-Gjakovë, por dhe për punën që bëri çifti Prele e Mri Kroj, për studimin, përgatitjen e botimit të monografisë së fshatit Kir, me titull "KIRI". Një punë e shkëlqyer, e thellë, historike, konkrete dhe e bukur nga çifti Prele e Mri Kroj. Ju lumtë dhe ua kam një kafe të mirë borxh, tha nder të tjera profesor profesor Tahiri. Pasi bëmë disa fotografi, u ndamë me profesorin, duke i uruar shërim sa më të shpejtë dhe të plotë, mirë u takofshim.

Pastaj, me batutat në mes Lulashit e Vuksanit, të kthehemi majtas, jo të kthehemi djathtas, u nisëm për në Deçan-Pejë-Rugovë.

Në Rugovë, "Rugova-kamp", na priti kryetari i Shoqatës "Martin Dreshaj", Ukshin Jashari, dhe plotë pjesëmarrës të tjerë, sekretari i shoqatës, Frasher Racaj, anëtar të kësaj shoqate, veprimtarja Barrie Shoshka, profesor Rexhep Abazi nga Medvegja, këngëtar Xhemal Berisha nga Gjinali, Vasel Nikçi, kryetari i ansambllit "RUGOVA", valltari Florim Nikçi, grupi nga Malësia, me veprimtarin Gjergj Camaj, aktorin e lahutarin Kole Vulaj, gazetarin Marash Dedevekaj, historiani Mark Junçaj dhe të tjerë pjesëmarrës, të cilët na nderuan jashtëzakonisht.

Pas një kafeje mirëseardhje, në orën 13.00 u futëm në një sallë, e përgatitur enkas për zhvillimin e kësaj veprimtarie, vendosur në formë të një "U", me presidium drejtues dhe në balle të sallës vendosur një banner, me shkrimin "SAKRIFICA KOMBËTARE PËR LIRI E PAVARËSI".

Kjo veprimtari u hap me "Valle Burrash", të ansambllit "Rugova", të interpretuar nga dyshja e famshme, valltarët Florim Nikçi e Fator Selmanaj, e cila u duartrokoi me ovacione.

Pastaj, në emër të grupit prganizativ, rolin e moderatorit e kishte aktori i hu-

morit, z. Fadil Grabovci, i cili duke alternuar prezantimin serioz e arkëtues e bëri më tërheqës, më të bukur këtë veprimtari. Pasi ftoj anëtarët e presidiumit të zënë vendet, fjalën e mori Frasher Racaj, sekretari i Shoqatës "Martin Dreshaj", në të njëjtën kohë dhe kryetari i Shoqatës "Lëvizja për Shqipërinë e Bashkuar".

Të parit ju dha fjala historianit Mark Junçit, i cili mbajti kumtesën me temë: "Kryengritja e Malësisë në vitin 1911 dhe roli i ngritjes së Flamurit të Gjergj Kastriotit në Deçiq", i cili jo vetëm që na pruri në kohë gjithë ato sakrificat të banoreve të



Profesor Tahir Bezhani e Ndue Sanaj



Vuksan Vatnikaj, Ndue Sanaj, Profesor Tahir Bezhani e Lulash Gjeloşi



Nga e majta në të djathtë profesor Rexhep Abzi, Ndue Sanaj, Frasher Racaj, Gjergj Camaj e aktori Ismet Krasniqi

Malësisë së Madhe në kryengritjen anti-osmane të viteve 1910-1911, e cila përfundoi me ngritjen e Flamurit Kombëtar, të Gjergj Kastriotit, në Deçiq, me kompetencë e komunikim të shkëlqyer me auditorin. I Lumtë!

Historiani Jusuf Mavaj mbajti kumtesën, me temë: "Akademiku Ali Hidri,

figure kombëtare në historinë e Shqiptarë".

Kolonel Ndue Sanaj, në pension dhe Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", mbajti kumtesën me temë: "Kontributi i Shqipërisë në Çlirimin e Kosovës", e cila do të botohet e plotë.

Gazetari Marash Dedevekaj, në RTV të Malit të Zi, redaksia në gjuhën shqipe, mbajti kumtesën me temë: "Ndikimi i mediave në Diasporë dhe kontributi i tyre në çështjen kombëtare", me mjaft kompetencë na paraqiti kontributin e medias në Diasporë në favor të çështjes kombëtare dhe që vijojnë pa ndërprerje.

varësi", e cila u paraqiti qarte e me shumë kompetencë.

Mbas mbajtjes së kumtesave, nëpërmjet të cilave na u soll në kohën e sotme freskia e atyre ngjarjeve luftarake për Liri e Pavarësi, me përmbajtje mjaft të thella luftarake e me sakrificat të jashtëzakonshme, të cilat u duartrokoi nga pjesëmarrësit me ovacione, filloi koncerti dhe recitimi i poezive kushtuar Lirisë e Pavarësisë nga autoret e tyre:

- 1 Poeti Agim Desku,
- 2 Poeti Ram Thaçi,
- 3 Poeti e piktori Idriz Berisha, me poezinë "Tokë e bardhë",
- 4 Aktori e lahutari Kole Vulaj, recitoj,



5 Lulash Brigja, poet, me poezinë "Kam pa një ëndërr"...,

6 Këngëtarin e instrumentistin Xhemal Berisha e profesor Rexhep Abazi, interpretim muzikor me sharki e çifteli,

7 Petrit Karaqica këndoj kënge për dëshmor,

8 Kreshnik Blaka, interpretim muzikor e kënge.

Këtë veprimtari i ndoqën dhe e dhanë mediat kosovare, si RTV FONTANA, RTV i KOSOVES, RTV i MALIT të ZI (shqip-Redaksia).

Gjate drekës e organizuar nga organizatorët e kësaj veprimtarie, u dhuruan disa libra, me titull "Dukagjini, Shqipëria ime aty", refleksione, pjesa e dytë, të autorit Ndue Sanaj dhe "KIRI" të autorëve Prele e Mri Kroj.

Pasi u ndamë me organizatorët e kësaj veprimtarie shkencore-përkujtimore e me pjesëmarrësit, u i larguam nga amjedisi i bukur të "Rugova-kamp", se pjesa zyrtare e pjesëmarrjes sonë kishte mbaruar, duke marrë pjesë në shumë veprimtari, kemi zenë dhe miq të shumtë, kishim planifikuar që t'u bëjmë vizitë disa prej tyre dhe menjëherë u drejtuam tek burimi i Drinit të Bardhë.

Grupi përfaqësues i Shoqatës, Ndue Sanaj, Pronarin e Hotel - Restorant "FLOGA" në Shkodër, Lulash Gjeloşi, inxhinierin e nderuar Vuksan Ndrevataj dhe Lulash Brigja e vijuan takimin e mbrëmjes në Radac tek "Ujëvara e Drinit", ku na priti miku ynë Luli Bërdynaj dhe kaluam një mbrëmje të kënaqshme dhe u çlodhem mirë.

Të Dielen, ditën e dytë e filluam po nga "Ujëvara Drini", ku na priti çifti Luli e Besnike Bërdylaj, së bashku me vëllain e Besnikes, Goni Blakaj dhe me djalin e tyre, Liridoni. Një pritje tepër vëllazërore, me biseda nga më të ndryshmet e me humor. Kënaqësi e veçantë! Ju faleminderit çifti Bërdylaj! Pastaj vijuan ditën me takimin këngëtarin Fatmir Berisha, me të cilin vizituam kompleksi në Prekaz, jo se ishte i panjohur për

ne, por sa here ta vizitosh aq më shumë mbushesh me emocione e frymëzohesh për sakrificat e kësaj familje, e cila sakrifikoi gjithçka për Liri e Pavarësi. E gjithë familja me në Krye Heroin Adem Jasharin u sakrifkuan duke renë në altarin e Lirisë e gjithë familja. Respekti e mirënjohje i gjithë kombi shqiptar për këtë familje, familjen e Jasharajve, që sakrifkuan gjithë familjen për Liri!

Nga kompleksi në Perkaz, shkuam në shtëpinë muze të piktorit e poetit Idriz Berisha-Xhixhi. Piktor i talentuar e poet i mirë! Pasi na takoi bashkëshortja e tij, Vjollca dhe na dha kafe e shoqëruar me një gote raki, vizituam Muzeun me piktura të tij. Një mrekulli! Aty njihesh në mënyrë të përkryer me punën e tij krijuese e të djalit të tij, Taulantit. Aty gjene pikurat e figurave më të ndritura të kombit, duke filluar nga Gjergj Kastrioti e deri te Shenjtorja Nënë Tereza. Sigurisht nuk mund të kaloni pa bërë fotografi dhe pastaj na përcolli deri në dalje nga avullia e shtëpisë së tij.

Kur ne ishim gati për të levizur drejt Shkodrës, miku ynë i nderuar, i cili na shoqëroj kudo ditën e Diel, kengetari Fatmir Berisha, se si na solli nëpër disa kodra me peisazh piktoresk dhe perfundam në ambientet e Resorant "Beni". Një shërbim tradicional, cilësor e i shpejtë, dhe kaluam disa ore të bukura. Nuk na mbeti asgjë tjetër vetëm të falënderojmë z. Fatmir, një burrë i qetë, i matur edhe shume bujar.

Ne orën 15.30 u nisem për ne Shkodër, duke marre me vete gjithë ato mbresa të pashlyeshme nga memoria e jone.

Vërtetë një vizitë shumë e bukur dhe e paharruar!

Me këtë rast falënderojmë mundësorin e kësaj vizite dy ditore, zotin Lulash Gjeloşi, pronari i Bar-Restorant "FLOGA", të cilin e falënderojmë për bujarinë dhe bukurinë që i dhuroi këtij udhëtimi. Gjithashtu falënderojmë inxhinierin Vuksan Ndervataj, për nivelin e tij kulturore e bashkëpunues! Ishte kënaqësi e veçantë që ishte pjesë e jona.

Tre opinione të veçanta:

Profesor Tahir Bezhani: "Krenari e kënaqësi ishte kafeja me Juve në Gjakovë! Ardhshi sa më shpesh!"

Ju falënderoj nga zemra që më kujtuat në këtë mëngjes të hershëm me kafën e mëngjesit! Në veçanti më lumturuat për dhuratat, por e veçanta është libri "KIRI", të autoreve Prele e Mri Kroj, që dhe unë kam bërë përpjekje të jap kontributin tim modest. Zoti ju bekoftë!"

Piktori e poeti Idriz Berisha Xhixhi: "Më nderuat mua dhe galerinë time me vizitën tuaj vëllezër shkodranë, ju që po e mbani kurdoherë të gjallë lidhjen tonë shpirtërore e kulturo-historike. Përzemërsisht falënderoj me këtë rast: kryetarin e Shoqatës Shoqata Atdhetare Dukagjini -Shkodër z. Ndue Sanaj, me shokët aktivistë Lulash Brigja, afaristin Lulash Gjeloşi, ing. Vuksan Ndrevaraj, këngëtarin Fatmir Berisha. U takofshim në gëzime të përbashkëta!"

Çifti Luli e Besnike Bërdylaj: "Një darkë dhe një mëngjes i bukur me miq... Ju faleminderit shumë për vizitën që na bëtë miqtë tanë Shkodran, z. Lulash Brigja, z. Ndue Sanaj, z. Lulash Gjeloşi dhe z. Vuksan Ndrevaraj! Faleminderit për dy librat që na i dhuruat! Gjithmonë respekti



Fotografi me pjesëmarrësit në këtë veprimtari



Nga e majta në të djathtë, Besnike e Luli Bërdylaj, Lulash Gjeloşi, Lulash Brigja, Ndue Sanaj e inxhinieri Vuksan Vatnikaj



Pamje nga shtëpia e Jasharjave

Nga e majta në të djathtë Ndue Sanaj, Fatmir Berisha, Vuksan Vatnikaj e Lulash Gjeloşi nga ne!"

Kumtesa e plotë, e kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", që u mbajt në këtë veprimtari:

I nderuar zoti Ukshin Jashari, Kryetar i Shoqatës "Martin Dreshaj"!

Të nderuar zonja e zotërinj të pranishëm!

Në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dhe në emër të grupit pjesëmarrës, ju sjell përshëndetjet më të sinqerta vëllazërore, dhe i urojmë punë të mbarë kësaj tryeze, në realizmin e qëllimit

min e Kosovës, drejtuesit e UÇK-së së bashku me udhëheqësin politik të saj, sot në 22 vjetorin e Çlirimit të Kosovës, janë të arrestuar, janë në proces gjykim.

Megjithatë, po bëj përpjekjet e mia modeste të paraqes para jush këtë kumtesë sa më të pranueshme.

Kosova ka qenë dhe është pjesë, e nacionalitetit Shqiptare, pavarësisht kalimeve historike, që nuk kanë ecur pa lanë gjurmët e veta, të cilat nuk lejuan bashkimin e një kombi në një shtet të vetëm. Prandaj edhe në kohën e Monizmit, Kosova nuk ishte vetëm, ashtu që dhe sot Kosova nuk është vetëm në përballimin e sfidave të kohës.

Dua t'u paraqes dy momente:

Së pari: Në ato vite, kuadrot dinin vetëm aq sa ju duhej për të ditur. Kështu, në këtë këndvështrim më lejoni t'ju them një moment të jetës sime.

Me datën 20 shtator 1980, në ora 07.00, në Kam të Tropojës, takoj Maliq Sadushin, i cili ishte Z/Ministri e i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, dhe shoqërohej nga Komandanti i Korpusit, Muharrem Mulgeci. Pasi pimë kafe, në një bar-kafe të qytezës së Kamit, u nisëm për në kodrat e Helshanit. Ushtarakisht nuk i thuhej kodrat e Helshani, të fshatit Helshan e Kosturt, por "Koka e Helshanit". Maliqi, pyeti për gjendjen e fortifikimit të këtij rajoni, për nivelin e fortifikimit të këtyre kodrave, që ishin vija e ndalimit me çdo çmim e kundërshtarit dhe do të ishte bazë e nisjes për dhënien e Kundërgoditjes së Korpusit të Këmbëorisë me rezervat e tij, si dhe për dhënien e Kundërmësymjes me rezervat e Komandës së Përgjithshme të Forcave të Armatosura.

Ato, kodrat e rajonit të Halshanit, "Koka e Helshanit" ishin të fortifikuara në 12 vija zjarri dhe kishte rreth 1 200 qendra zjarri (qz) të tipave të ndryshme, 128 pozicioni zjarri (pz) topi KT 75 mm, pz për artilleri të rëndë, vendkomanda, strehime për rezervave deri në 6 muaj luftime, e të tjera e të tjera. Kjo vizite, në rajonin e kodrave të fshatit Helshan dhe Kostur nuk ishte e rastësishme. Maliqi ishte Z/Ministër i Mbrojtjes, që mbulonte përgatitjen luftarake të ushtrisë e personelin, dhe në këtë kohë Z/Ministër i Mbrojtjes për fortifikimin ishte Alfred Moisiu, dhe nuk kishte pse të interesohej drejt për së drejti për fortifikimin e zonës së Hasit dhe në veçanti për atë rajon, që cilësuam më sipër "Koka e Helshanit".

Shumë vonë, pasi vitit 1991, u fol shumë dhe u shkrua në gazetën "Shekulli", "Panorama" dhe "Shqiptarja", në veçanti në gazetën "Kombi" të marsit të vitit 1993, nga ish Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, të Ushtrisë Shqiptare, Veli Llakaj, u paska planifikuar e hedhur në letër një Plan Operacioni i Ushtrisë Shqiptare, për të çlirim e vitit 1980, dhe Maliqi paska qene një nder tre anëtarët kryesor të grupit të punës për përgatitjen e këtij operacioni. Atëherë i thërras kujtesës dhe më kujtohet vizita e Maliq Sadushit në kodrat e Helshanit. Bëra përpjekje të lidhi vizitën e tij në atë kohë, me informacionin, që na jepet pas gati 10-15 viteve, dhe them: -Kjo mund të ketë qene arsyeja e asaj vizite të Maliq Sadushit, në kodrat e Helshanit.



Pra, në fillim të vitit 1980, ishte planifikuar operacioni strategjik për çlirimin e Kosovës dhe në këtë operacion strategjik do të merrnin pjesë rreth 120 000 trupa nga të gjitha llojet e armeve e shërbimeve, duke përfshirë dhe aviacionin.

Së dyti: Në vitin 1981-1982, në kohën e demonstratave të studenteve, kam qene në detyrën e Komandantit të Brigadës së Këmbësorisë në zonën e Hasit dhe më ka takuar rasti të pres me dhjetëra student e studente, të cilët kaluan në zonën e Hasit, dhe ne i bashkonim e i drejtonim për në Kukës, ku ishte qendra e vendosjes së tyre.

Përgatitja për pjesëmarrjen e Shqipërisë në çlirimin e Kosovës së bashku me forcat ushtarake të NATO-s filloi herët. Në muaji gusht të vitit 1998, erdhi një ekip i NATO-s, në Divizionin e Këmbësorisë së Shkodrës, në Vau-Dejës, në mes të cilëve ishin dy gjeneral. Ata, po sa ndaluan në mjedisin e Brigadës, dhe na njohën pak me detyrën e tyre, dolëm në qafë Çelë dhe në lartësitë e Pukës. Ata, në atë kohë kishin ardhur për përnjohjen e terrenit, për vendosjen e Forcave Tokësore të NATO-s, se ishte një ide, që Forcat Tokësore të NATO-s të futeshin në Kosovë nga drejtimi i Kukësit ose i Tropojës. Ato nuk erdhën në këtë drejtim, ndoshta për shumë arsye, por në mes të tjerave ishte që të mos implikohej drejtpërsëdrejti Republika e Shqipërisë, në këtë ndërmarrje të Forcave Tokësore të NATO-s.

Mbështetja ishte në të gjitha fushat, por kryesisht në fushën diplomatike, në fushën ushtarake dhe në fushën ekonomike.

Në fushën diplomatike, me datën 18 mars 1999 delegacioni i Kosovës, më në krye Hashim Thaçin, pas shumë përpjekjesh të qeverisë Shqiptare me në krye Pandeli Majkon dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, profesor doktor Paskal Milo, Presidentin e Republikës së Shqipërisë profesor doktor Rexhep Mejdani, u firmos akti në Rambuje. Kundra kësaj marrëveshje të rëndësishme dhe jetike për Kosovën ka qene profesor doktor Sali Berisha, kryetari i PD-s në Opozitë në atë kohë, i cili pati theksuar: *"Kush shkon në këtë Konferencë, është tradhtar i Kombit!"*. Madje edhe figura e personalitete kosovare, me dashje apo nga naiviteti i tyre, pati kundër kësaj marrëveshje, si Adem Demaçi, të cilët këmbëngulnin, që me çdo kushte të mos firmosej marrëveshja e afruar nga Grupi i Kontaktit, në Rambuje, kur dihej, se në qoftë se kjo firmë nuk do të hidhej, Kosova edhe sot mund të ishte nën Serbinë.

Në fushën ushtarake, përveç përgatitjes së grupeve speciale ushtarake të UÇK-së në thellësi të vendit, si në Fark të Tiranës, në rajonet e Burrelit apo në thellësi të Kukësit e të Pukës, forcat ushtarake të Divizionit të Këmbësorisë së Kukësit dhe një pjesë e forcave ushtarake të Rezervës së Komandës së Përgjithshme kishin marrë detyrë për të mbështetur Forcat e UÇK-së, për t'iu siguruar atyre shpinën e tyre dhe për të përballuar çdo aventurë, që mund të merrnin Forcat Ushtarake Serbe ndaj Shqipërisë. Në periudhën prej rreth tre muajve, 24 mars deri me 12 qershor 1999, në hapësirën Zonës së Mbrojtjes së Divizionit të Këmbësorisë të Kukësit, nga Morina e Kukësit e deri në Morinë të Tropojës pati rreth 14



Një foto para Shënjetores Nënë Tereza, Vuksan Vatinikaj, Lulash Gjeloşi, Ftamir Berisha, Ndue Sanaj e Idriz Berisha



operacione luftarake në mes të forcave ushtarake serbe dhe shqiptare, që në këto operacione morën pjesë jo pak forca këmbësorie, artilerie, zbuluese, xheniere e të armëve e shërbimeve të tjera, të drejtuar nga kuadrot e niveleve të ndryshme dhe në mënyrë të veçantë nga Komandanti i DK të Kukësit, Gjeneral Brigade, Kudusi Lame dhe komandanti i For-

cave të Rezervave të Komandës së Përgjithshme, Kolonel Sulejman Abazi, kryesisht në rajonet: e fshatit Dobrunë, në drejtim të fshatrave Stotobërdë dhe Zherkë, në fshatin Kamenicë, në Tropojë e Vjetër, nëpër Gegaj, në Padesh e Koshare, në Qafën e Morinës, fshati Kasaj dhe mali i Gështenjave, në afërsi të Majës së Zezë, në majën e malit të Zymit, në Cahan, Kishaj e Pogaj, në goditjeve nga Qafa e Prushit, në mali i Kralicës, në Goden, në rajonet Gorozhup, Plane e Zhur dhe në Zherkë e te tjera. Përveç këtyre masave pati jo pak kuadro të Ushtrisë Shqiptare aktiv ose në rezervë, që morën pjesë drejtpërsëdrejti në luftën për çlirimin e Kosovës, duke u bërë pjesë e forcave të UÇK-së deri në detyrën e z/Shefit të Shtabit të këtyre forcave.

Edhe në Shkodër forcat ushtarake ishin në gatishmëri numër NJË! Në Divizionin e Këmbësorisë në Shkodër, me komandant Kolonel Flamur Muça, u ngritën forcat e gatshme, me të cilat me 12-15 mars 1999, u përgatitë e u zhvillua një stërvitje komplekse, në rajonin e Koplikut (përroi i Thatë) në prezencën e Kryeministrit, Pandeli Majko; Ministrit të Mbrojtjes profesor doktor Luan Hajdaraga, të Kryetarit të Komisionit të Jashtëm, Sabri Godo, (plakut të urte të Kuvendit të Shqipërisë) dhe kuadrove të lartë të Shtabit të Përgjithshëm, me në krye Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Aleks Andoni dhe të tjera kuadro të pushtetit vendor. Madje, gjatë muajit mars e prill u organizua një Divizion Këmbësorie, me një efektiv rezervist me rreth 12 000 vete, me të cilët u zhvillua stërvitje pesë ditore.

Në fushën ekonomike e humane, vetëm në rrethin e Kukësit u pritën dhe u trajtuan në mënyrë shembullore, afro 450 mijë shqiptarë të dëbuar nga trojet e tyre, nga trojet e Kosovës. Edhe në qytete apo hapësirat e tjera gjeografike shqiptare u pritën vëllezërit e motrat kosovare. Edhe në pallatin ku banoj unë ishte një familje, një grua nga Istogu, me emrin Ziza (kësh-

tu e thërrisnin), me një vajzë e me vëllain, së cilës forcat paramilitare Serbe i kishin mbytur njërenë vajzë në pus, e tjera.

Për këtë akt të madh humanitar, Kukësi, në vitin 2000 është kandiduar për çmimin **Nobel** për paqe. Në këtë mënyrë Kukësi u bë qyteti i parë në botë i kandiduar për një çmim të tillë, për mikpritjen dhe bujarinë ndaj popullit vëlla të Kosovës.

Me datën 24 mars 1999, rreth orës 16.00 filloi një histori e re për nacionalitetin shqiptar, e cila bëri të mundur, që të gjithë bashke, secili në rolin e mundësitë e veta, nga njëra anë Ushtria e Çlirimtare e Kosovës, Forcat Ushtarake të NATO-s dhe Shqipëria, bënë të mundur, që pas 80 ditë luftime nga toka e nga ajri, me datën 12 mars 1999 Forcat Tokësore të NATO-s të futen në Kosovë nga drejtimi i Maqedonisë së Veriut dhe të çlirohet Kosova, e cila sot është Republika e Pavarur.

E cilësoi me të madhe këtë datë, jo vetëm që pas një shekulli e më shumë populli i Kosovës u Çlirua një here e përgjithmonë nga thundra Serbe dhe sot është Republikë e Pavarur, por kjo datë na thotë, se u hap rruga për Lëvizjen e Bashkuar të Shqipërisë, bashkimi i Kosovës apo Dardanisë me shtetin Amë, Shqipërinë.

Kurrë më shumë se sot, Shqiptarët nuk janë më faktor përcaktues në gadishullin Ilirik!

Shqiptarët janë dy republika! Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë pjesë e formimit të Shtetit! Në Mal të Zi, janë dy komuna shqiptare dhe kanë përfutur të gjitha të drejtat e përdorimit të simboleve kombëtare shqiptare.

Pra, kjo situatë në favor të shqiptarëve, para 25 viteve as nuk mund të mendohet, por, duhet që politikanët tanë të kenë vizionin përgjegjës dhe duhur, për të përfutur nga kjo situatë politike e krijuar, të marrin nga politika Globale atë që duhet për shqiptarët,

Lavdi të gjithë atyre që kontribuan dhe derdhen gjakun për Çlirimin e Kosovë!

Ju faleminderit për vëmendjen që më kushtuat!

Vizita te vëllezërit tanë në Kosovë, kanë qenë, janë dhe do të mbeten shumë mbresëlënëse.

Ndue Sanaj e Lulash Brigja



Po botojme për lexuesin e gazetës “Dukagjini”, nga libri “Monolog me veten”, të autorit Meritan Spahia, monologun “Çështje Nderi”, për të cilin presim mendime nga lexuesit.

Çështje Nderi

një meditim i shkurtë në muajt
e nxehtë të diellit 616, mbas Trojës

Për çudi, nuk ishte i verbër.

Është bërë traditë a së paku zakon që, ndërsa këndohen ato këngë të lavdishme, ata që dëgjojnë presin që rapsodi të jetë i verbër. Nuk e di pse ka lindë kjo legjendë, apo kjo pritshmëri. Për sa më ka rastisë të jem i pranishëm, kurrë ndonjëherë nuk kam parë të jetë i verbër. Ndoshta ky është një figuracion, që ka lindur mbase për të theksuar përkushtimin e rapsodit, a për ta bërë atë, jo vetëm transmetues, por edhe përjetues të atyre ngjarjeve; verbëria e tij është lypur e nevojshme, për të treguar se ai tjetër nuk jeton, a përjeton, por veç ato që rrëfen.

Zëri i tij është i plotë, i qetë, i ngadaltë dhe kumbues herë-herë. Kurrë vajtues. Edhe se këndon për rënie trimash, beteja heronjsh, apo humbje që i përngajnë më shumë therorive, toni i tij nuk është kurrë mëshirëndjellës, përlothes, qaraman. Përkundrazi, kur ngjarja kulmon, zëri i bëhet i fortë, i trashë, i ashpër dhe, i rrëmbyer në rrëfimin e tij, i harruar se në një botë dhe në një kohë tjetër jeton, ky këndim të përngjet me gjamim resh, stuhish apo vetimash, i cili, përmes fjalëve të tij, të duket se konkretizohet me vringëllimën dhe tingëllimën e mprehtë të tehut të shpatave të përplasen duke shkëndijëzuar...

Kur mbaron, gjithmonë për disa çaste, pas atij gjamimi a vringëllimi, dëgjon të pasojë tingulli i lahutës, e cila mbyll këndimin me tinguj të zgjatur, çka të ndihmon të kthehesh butë në realitetin të cilit i përket. Për çudi, edhe se ka shoqëruar rrëfimin gjatë gjithë kohës, vetëm atëherë e vë re, vetëm atëherë kujtohesha për të. Mbase, ky është çasti i përshtatshëm kur ti ia ke nevojën, pas atij rrebeshi vringëllimash, që e kanë shurdhuar krejt. Vetëm kur edhe ajo pushon, kujtohesha se nuk ishte aty, atje, por këtu, tani, duke përjetuar atë... Kur edhe këtij kapërcyelli i vjen fundi, një heshtje e gjatë pason, e domosdoshme “për t’u kthyer”.

Gjithmonë kam menduar se ato ngjarje, ajo luftë absurde, ka qenë e tillë, ashtu siç e tregojnë rapsodët... Me një besim të verbër në rrëfimin e atyre që duhet të ishin të verbër, jo vetëm i kam imagjinuar ato kohë betejash dhe ato kohë heronjsh ash-tu, siç i rrëfenin ata, por edhe përjetuar...

Por, ajo që desha të thoja është se, së fundi, ato ngjarje, për ata heronj, ajo luftë, që prej një gjame të madhe burrash është pasuar, po interpretohet.

Në të ritë tim, kur ndodhte të dëgjonim rapsodin, nuk kishte diskutime, por në heshtje ktheheshin me solemnitë kupat (aq sa u shkon atyre solemnitëti) dhe, dalëngadalë, si me gjysmë zëri, si në gjysmëheshtje, për të mos prishur meditim e gjatë që shkaktonte ai përjetim rapsodik, burrat fillonin të bisedonin, ndonjëherë edhe për gjëra që nuk kishin të bëjnë me atë që dëgjuan. Ndodhte, ashtu siç ndodh kur del nga tempulli: ndërsa

gjatë ndejes aty je i mbështjellë më një solemnitëti, thuajse i shkëputur nga bota të cilës i përket, me të dalë jashtë, jo se shkëputesh menjëherë, por sikur me plotkujdes e si për të mos e zhveshur dhunshëm shenjtërinë, hyn pak nga pak e pa bujë në jetën reale. Qëllon që, si ke takuar një mik rrugës, t’i thuash me gjysmë zëri:

- Nadja e mirë...

Ky, duke mos e kuptuar ngathjen tënde, mund edhe të të mos e kthejë përshëndetjen...

Mirëpo tani (e pra, nuk ka kaluar edhe aq shumë kohë, diçka më shumë se nja dy dekada), sa herë që dëgjoj të këndohet për Luftën e Trojeve, për betejat mes atyre heronjve, për triumfin e Akejve apo për shkumbosjen e më të bukurit dhe madhështorit qytet të Frigijsë, pas një heshtjeje relativisht të gjatë që thamë e që pason domosdoshëm zërin këmbues dhe dramatik të rapsodit, është e pamundur të mos dëgjoj komente të çuditshme mbi atë ngjarje që, edhe se kanë kaluar disa qindra vjet, ende nuk është harruar, ende trazon zemrat e atyre që i dëgjojnë, ende nxit fantazinë e ëndërrimtarëve.

- Nuk ka qenë punë nderi, - më në fund guxon ndonjë të thyejë heshtjen. - Nuk ma do mendja. Këtu është luajtur një lojë më e madhe se huret e Helenës.

- Ka mundësi, - e mbështet ndonjë tjetër, ekspert në çështje diplomacie si dhe konspiracioni ndërishullor.

Kaq duhet. Pastaj, nën efektin e trazimit të zemrave nga ana e rapsodit, çka ndihmohej skajshëm edhe nga vera, që pas këndimit rridhte më shumë, nisnin trajtimet me detaje se si e pse, në të vërtetë akejt, danajt, lakonët e të tjerë u mblodhën së bashku për të fshirë nga faqja e dheut Trojet... Sipas tyre, bëhet fjalë për donimancë! Kush e kush më shumë, YlliOni, apo ata, aleatët e Spartës, të kishin ndikimin e vet në detin Egje. “Tashmë për Kretën nuk bëhej më fjalë”, - arsyetonin. Kishte disa shekuj që rrinte e heshitur, e vetëdijshme për pozicionin e ri që kishte, me zhvillimet e fundit që ishin bërë në fushën e teknologjisë. Peloponezi dhe Atika ishin më të pasura tashmë: ata mbillnin tokën, ndërsa kretanët ende merreshin me mjeljen e dhive. Kurse Athina priste një çast më të volitshëm për t’u bërë protagoniste. Thuhet se, hë për hë, po merrej me shkollim të fëmijëve. U mësohej të shkruanin. Thonin se ata, këngët që ne i dëgjojmë të këndohen nga rapsodët, kishin filluar t’i shkruanin. “Po, ç’është shkrimi?!” - pyesnin njerëzit. Kush mund t’i përgjigjej vallë?! Ndonjë, që kishte pasur rastin të shkante atje, thoshte se ata kishin mësuar ta ruanin në papire zërin e rapsodit. Thonin se, kur nuk gjendej ndonjë rapsod pranë, ndokush, çdokush, merrte papirin ku ishte ndry zëri i rapsodit (thua të ishte magji, s’e besoj), e çrrotullonte dhe me sy ngulur aty, këndonte çfarë shihte. Ndoshta jo me të njëjtën mjeshtri si e rapsodit, por së paku pikë për pikë, pa shmangur asnjë fjalë. Madje, jo vetëm kaq. Kishin filluar të ndryenin aty edhe dituri të tjera.

Kur dikush guxonte të thoshte këtë, apo të fliste disi kështu, të tjerët që dëgjonin,

gajaseshin. Si ishte e mundur të ndryhej zëri i rapsodit në papir, more... hahaha. Ndonjë i motshëm i vinte vulën:

- Si duket, kemi jetuar më shumë se ç’duhet, për të dëgjuar gjithfarë marrëzish.

Të them të drejtën edhe mua këto më duken çudi, por gjithsesi, kurioz jam të shoh se çfarë bëjnë athinasit...

Të kthehem. Po thonim se ajo histori dramatike arsyetohet nga “mendimtarët” si diçka që duhej të ndodhte një ditë. Gjithë ai rivalitet: ngushtica e Dardaneleve, si dhe ajo e Bririt të Artë, kontrolloheshin... Sa herë dëgjoja këto marrëzi, më bëhej të ngrihesha dhe t’u thoja:

- Të marrë!

Ndërsa kështu diskutojnë, kam menduar e pyetur veten: pse vallë nuk u besojnë më rapsodëve?! Ç’i shtyn të thonë a të supozojnë gjëra që të lashtëve me gjasë nuk u ka shkuar ndër mend?! Mandej, ta zëmë se këta paskan të drejtë, pse rapsodëve u ka interesuar të fshehin qëllimin real; pse, edhe pas kaq shumë vjetësh, u duhet të jenë pjesë e një komploti e të vazhdojnë ta kamuflojnë atë me kaq këmbëngulje, kur asnjëherë, në asnjë fragment të kësaj historie, nuk kanë mbajtur anën e kurrkujt, por i kanë kënduar me aq patos heronjve, pavarësisht kraht?! Po të ishte ashtu si mendohet tani nga fanatikët e teorive të konspiracionit (të mençur fort, a din!), që arsyeja ka qenë diku tjetër, jo nderi, ç’i ka penguar rapsodët të thonë të vërtetën?! Po të ndodhte ndryshe, pra që ata fshehin diçka, kjo tregon se, ose janë friguar për ndonjë gjë, ose vetë kanë qenë pjesë një komploti absurd. Por, si ka mundësi, që të jesh pjesë e një komploti aq konspirativ, apo (rrethana më lehtësuese) të frigoshe me thanë të vërtetën dhe të arrish me magjepsë mendjet dhe rrëmbesh zemrat e aq brezave me një histori të shtirur; si ka mundësi që një poet a rapsod të ndezë fantazinë e dëgjuesve e të sugjerojë modele imitimi për të rinjtë me qindra vjet, duke pasur referencë të pavërtetën? Nuk ka se si...

Të them të drejtën, secili prej këtyre mendimtarëve, ekspertëve në fushën e konspiracionit ndërishullor e që nuk e merr aspak parasysh çfarë rrëfejnë rapsodët (prej të cilëve magjepsët dhe frymëzohet ashtu si unë), për një fyerje të vogël, është i gatshëm të shuaj një fis, madje, po të kishte mundësi, do shuante një popull. Madje, madje, për një fyrtje edhe më të vogël, nuk do ta kishte aspak të vështirë që, çdonjërin me të cilin po rrinë, ta ftojë në duel. Edhe se kanë pirë disa dhjetëra kupa verë së bashku... Kjo s’është aspak e rëndësishme! Veç nderi, ah, po! Veç nderi!

Çfarë ironie: këto nderëtarë, burra me mustakë e me mjekër të zezë, nuk besojnë aspak në një histori pastërtisht nderi, në një histori që mund të ishte e tyrja; në një histori që, po të kishin jetuar në atë kohë dhe t’i kishin ftuar të merrnin pjesë aty, pavarësisht se në cilin krah, mjafton të bëje pjesë në një çështje nderi, do të sakrifikonin po ashtu si ata, po aq lehtë si ata, ata të hershmit, të cilët këta i quajnë Etnit.



Ka disa arsye që duhet besuar dhe menduar se pse ajo luftë ishte pastërtisht një luftë nderi dhe aspak një luftë zotërimesh, siç pretendojnë ta paraqesin sot. Thjesht mjafton të arsyetojmë e, që të bindemi, mjaftojnë fare pak argumente...

Së pari, fakti që ata kanë pritur për një kohë të gjatë në gjirin e Aulidës erën e favorshme, tregon se ata nuk kanë qenë lundëtarë të mirë. Ndoshta nuk ka qenë faji i tyre, e tillë ishte teknologjia. Lundrat duhet të pritnin kohën e përshtatshme, madje stinën e përshtatshme, që të lundronin në det të hapur. E kishin të pamundur t’i largoheshin bregut shumë, në kohë dimri, aq më tepër në kohë stuhish. Ne nuk e dimë se koalicioni i spartanëve dhe akejve ishte thirrur në kohë dimri, apo kishte qëlluar që të binte shi i vazhdueshëm. Këtë as poetët, as rapsodët nuk na e kanë thënë kurrë. Si duket, nuk ka qenë e tillë. Sikur, për një ndërmarrje aq madhore, aq të rrezikshme, e cila do të ndryshonte fatet e njerëzimit, të ishte bërë arsye për pengesë një gjë aq banale, si koha e keqe (ta zëmë që të ketë rënë shi i vazhdueshëm, të ketë pasur stuhi marramendëse për një kohë të gjatë), patjetër do na e kishin thënë, në një mënyrë a në një tjetër. Për shembull, do të na thuhej: Hyji Zeus, duke parë se nuk i ishin bërë nderet e duhura për atë ndërmarrje të madhe, i fyer nga indiferenca e akejve, çoi shakullima ere, stuhi dhe shi, që t’u bëhej atyre pengesë, deri në çastin që ata të ndërgjegjësoheshin... etj., etj. Por, jo! Aspak! As poetët, as rapsodët nuk e nënvizojnë këtë fakt. Nuk ka pasur shi, as dimër nuk ka qenë. Kështu, i bie që ata, për ditë të tëra, ndoshta për disa hëna, janë bllokuar në Aulidë, vendin e grumbullimit të të gjithë flotës. Po aq janë vonuar, sa tregimet e motshme thonë se shumë princa qenë revoltuar, madje edhe vetë Odisea ka kërcënuar se, nëse nuk do të jepej urdhri për nisje, do të braktiste fushatën. Ku të shkonin ata pa të?! Vërtetë që Akili ishte luftëtar i shkëlqyer, por Odisea ishte komandant i mrekullueshëm, mendja gjeniale e ushtrisë së akejve. Edhe se në dukje nuk përbente një fakt të rëndësishëm, po të ikte ai, patjetër do të ikte edhe Diomedi, krahu i fuqishëm i asaj mendje gjeniale... Ç’do bëhej me ta pastaj?! Kështu, duke u gjendur në ngushticë, që do të thotë duke u gjendur në pazotësi për të lënë brigjet, edhe se era ishte e pafavorshme, Agamemnoni ishte detyruar të thërriste orakullin, Kalkantin, që të luste zotat për një erë të mirë. Ky e ka këshilluar që ata qetësohen vetëm me gjakun e më të bukurës vajzë të tij... I shkreti mbret!

Së dyti, fakti se ata i janë drejtuar orakullit për ndihmë, që ai të ndërhyjë në

mënyrë mistike pranë fuqive madhore, të cilët, për mentalitetin e tyre (gjë mjaft e mirë), kanë qenë gjithmonë fuqi me autoritet të diskutueshëm, që madje janë sfiduar mjaft shpesh nga njerëzit, qoftë për fuqinë fizike, qoftë për fuqinë e mendjes, tregon se ata, në atë vështirësi, në atë ngut, në atë nevojë të domosdoshme për t'u hipur lundrave, kanë çeduar në këmbënguljen dhe besimin "symbyllur" tek dituria. Ai që din, nuk mund t'u besojë verbtazi dikujt të cilin e sfidon për nga mençuria. Fakti që ata kanë çeduar në këmbënguljen e tyre ndaj racionale, dhe u janë drejtuar iracionale, tregon se ata nuk kanë qenë aq të ngulur në dituri; kjo tregon se, edhe se për një çast, ata i besuan më shumë orakullit që fliste me vete, se sa lundrave; çka do të thotë, edhe se në mënyrë të tërthortë, e përsërisim, se ata nuk ishin lundëtarë aq të zott, njohës aq të ditur. Nëse këtë hamendësim e konsiderojmë fakt, mund të themi se me padituri nuk mund të sundohet deti, aq më tepër të dominohet e panjohura... Kështu, ai mbret i fuqishëm, që kishte thirrur në shërbim të tij, qoftë edhe se për një kauzë të drejtë (çështje nderi), të tjerë mbretër apo bij mbretërisht, për një nevojë të ngutshme, apo kompromis të domosdoshëm, kishte rënë në kurthin e besëtytnisë. Këtu ka vend për të parë nga afër edhe një tjetër çështje. Nëse ky mbret, Agamemnoni po them, ka besuar në besëtytni, dhe me atë akt makabër, therjen si fli të së bijës (parakeo, përndryshe parakes apo paraqes - që qet për therje para hyjnive një kafshë apo njeri), ka besuar se qetëson zemërimin e zotave, kjo tregon se sa larg ishte ai dhe gjithë çfarë ai përfaqësonte nga dituria. Por, nëse ky mbret, nuk i ka besuar aspak orakullit, që e këshillonte me këmbëngulje paraqitjen e së bijës zotave, dhe përsëri e ka bërë, për të qetësuar "prijësat rebelë", kjo tregon se ai pas vetes ka pasur as trimash, që mund t'u thohet gjithshka të duash, por të ditur, a së paku racionalë, kurrsesi... Në mos pastë qenë vetë, ka pasur bashkëpunëtorët e tij, më të ngushtët dhe të domosdoshmit, besëtytë. Por, me besëtytë, a i hyhet detit?! Për luftë padyshim, por për dominim hapësirash të pamata, kontrollë gjresh apo ngushticash, kurrsesi! Sapo therën Ifigjeninë e shkretë, sjellë aty pabesisht, siç nuk e kanë pasur asnjëherë zakon, thonë se era paska pushuar; thonë se stuhia qenka fashitur... Mendoj se edhe pa therur Ifigjeninë, po të dinin të lundronin më mirë, po të dinin të lexonin konfiguracionet yjore dhe lëvizjen e tyre në kupën e qiellit, apo po të njihnin më mirë shkencën e ndërtimit të lundrave, siç e njohim sot së paku, do të dilnin nga gjiri i Aulidës pa as më të voglin ngurrim apo dyshim; do të arrin ku dëshironin - në brigjet e Frigjisë, pa as më të voglin shqetësim, edhe sikur të frynte një erë e kundërt, apo edhe sikur deti të ishte i trazuar...

Nuk mund ta vëmë në dyshim, ata ishin pionierë të flotës ushtarake, ashtu siç kishte qenë një argotan pionier i lundrimit, por nuk ishin ende zotërues të deteve, kontrollues të ngushticave, pushtues të botës së njohur. Jo, në asnjë mënyrë! Këto janë fantazitë tona, të modernëve. Ata ishin trazuar, me njëqind mijë luftëtarë, me mijëra lundra dhe, mbi të gjitha, me zemra të fryra, për të kaluar detin Egje

dhe për t'u ndalur në brigjet e Frigjisë, të çojnë nderin në vend, mbasi ishin ndjerë të fyer.

Së treti, si kanë djegur e shkruar kulm e themel qytetin, si kanë shfryrë më në fund dufin, si kanë çuar në vend nderin, çka u ka kushtuar atyre më së pari aq shumë, kanë marrë të kthehen. A ishin tashmë të qetë, a ishin tashmë të kënaqur? S'e dimë. A do mund të dilnin në breg të detit, në kohën e perëndimit të diellit, në ditët e nxehta të verës dhe, me dorë mbi sy, të shihnin vijën e horizontit, andej nga dikur ishin Trojet. Nuk e besoj. Nga netët e tyre ishte tretur gjumi. Nuk shihnin ëndrra të frikshme. Puna ishte se nuk shihnin më ëndrra. Kështu i pat thënë Atridi Menela Telemakut, kur ky, njëzet vjet më vonë, bujti në Spartë, për të pyetur për të atin.

- Ende kam netë të trazuara, - kishte thënë. - Kujtimi i miqve që nuk i kemi më dhe humbja përgjithmonë e atyre që duhet t'i kishim miq, më bën të mos mbyll sy.

Sidoqoftë, të trishtuar apo jo, të përmalluar apo jo, kurrsesi entuziastë për atë fitore të madhe, por mbi të gjitha mbase të penduar, u kanë hipur lundrave për t'u kthyer... Por, sa u kthyen? Një pjesë e madhe e flotës qe mbytur. Këtë fat ka pësuar Odisea, Ajaksi i Madh, Diomed, thonë se edhe Enea. Për të qenë të saktë për punën e Odiseas, thonë se disi ia ka dalë, por të tjerë e mohojnë.

- Ka shkuar përtej Shtyllave, - thonë...

- Ka luajtur me detin, - thonë...

Kështu thonë ata që mendojnë se është mbytur diku në oqean, përtej Shtyllave të Herkulit. Si është e vërteta nuk di asgjë. Por desha të them se, po të ishin zotërues të detit, madje, po të synonin një dominancë mondiale dhe të shikonin pengesë njëri-tjetrin, së paku duhet të ishin në gjendje të ndërtonin lundra më të forta...

Së katërti, duke marrë si referencë ata që thonë kështu, Odisea ka vonuar të kthehet në Itakë afërsisht dhjetë vjet. Thonë se ka drejtuar lundrat drejt veriut, drejt Itakës, por erërat e kanë çuar në perëndim. Disa thonë (por nuk e besoj), se këtë e ka bërë me dashje. Meqë jemi në lundër, paska thënë, të hedhim një sy andej e të shohim çfarë ka deti në perëndim. Kishte dëgjuar se nuk ka njerëz atje. Nuk e pat besuar, ndaj desht ta provonte, meqë në lundër ishin... Gjete njerëz, por të çuditshëm. Disa shtatshkurtër, disa shtatë-lartë. Në këtë aventurë, thonë ka humbur gjithë flotën. Nuk i ka mbetur asnjë lundër e vetme. Gjithsesi, nuk jam i prirur ta besoj këtë histori. Kam bindjen se erërat e kanë çuar andej nga nuk ka dëshiruar dhe ka mbetur peng i tyre, endacak i detrave e në mëshirë të fatit. Legjenda thotë se një mbret i mirë i paska dhënë një shakull, ku ka mbledhur të gjithë erërat, në mënyrë që këto të mos e pengonin gjatë kthimit, por prapëseprapë nuk ka arritur të kthehet. Është endur për aq kohë në detin e madh, pa mundur të orientohet. Mendoj se nuk ka qenë faji i tij, nuk ma merr mendja se nuk ka ditur të drejtohet nga veriu, por thjeshtë lundra nuk i është përgjigjur: as nuk ka qenë e aftë t'i përballojë stuhitë, as aq e shpejtë t'u ikë atyre.

Të njëjtën gjë thonë edhe për Enean, i cili, sipas disa varianteve të rrëfimeve, nuk është kthyer më në Frigji, por ka zënë vend në gadishullin e demit Ital, diku më

larg... Edhe ky, si ai tjetri, mendoj se ka mbetur peng i erërave, rob i dallgëve, në mëshirë e stuhive. Është ndalur herë në një breg e herë në një tjetër. Aq shumë është endur, sa kur njëherë nuk i ka qëlluar të ndalet në një breg, në tokat Epër, qenka çuditur me një qytet të ri, që i ish dukur si të ishte një tjetër Trojë, natyrisht, më e vogël. Ka bujtur aty dhe qe habitur se atë qytet e paska themeluar Hekuba dhe Andromaka, pikërisht në vendin ku i ka dërguar Agamemnoni, ashtu siç i pat premtuar Priamit, para se të ndahen. Me këtë dua të them se, aq shumë është endur deteve, sa të tjerët kanë pasur kohë të ndërtonin qytete, madje të bukur. Atë qytetin që i pat bërë përshtypje, e kishin quajtur Butros, ngaqë ditën e zbarkimit aty të zonjave qenë therur shumë dema, ata që i pat dhuruar kreshniku, pikë për pikë siç i pat premtuar kreshnikut tjetër...

Dikur, pas shumë vitesh, vendosi të lidhë lundrën e të mos niset më. I lodhur dhe i rrskapitur nga dallgët, shteruar nga udhëtimet, mërztitur nga ankesat e shokëve, pat vendosur të ndalet. I kishin mbetur pak lundra. Që të mos humbte më, qoftë ato, qoftë shokët, pat qenë i gatshëm edhe të luftonte me vendasit madje. Bregun ku qe ndalë, thonë se e ka quajtur Lac, në kujtim të vendlindjes së tij. Ngaqë luftoi me vendasit dhe i mundi, qe harruar si quhej përpara ai vend, sepse të gjithë përdorën emrin e ri. Por të kthehem. Përsëri them... Po të ishin aq të zotë, sa për të pretenduar dominancë në një det që i kërcënonte sa herë që u hipnin lundrave a, së paku, ngadalësonte udhëtimet e tyre, do të kishin ndërtuar lundra më të shpejta...

Tani më thoni: presin një kohë të pamatë, ndoshta disa hëna, në gjirin e Aulidës, për një erë të favorshme; u drejtohen orakujve që të mundin të dalin në det (sepse nuk janë lundëtarë të zot), madje sakrifikojnë bijat e tyre për këtë gjë (që e thekson edhe më shumë pazotësinë e tyre); ndërsa kthehen, gjysma mbytet dhe, ata që kthehen, një pjesë arrin në destinacion pas dhjetë vjetësh... A këta duan të dominojnë?!

Edhe një: që të zotërosh një det duhet që ky të ketë trafik dhe, të përfitosh, duhet të zësh ngushticat, të kontrollosh rrugët tregtare, të mbikëqyrësh portet. Po ç 'porte, a ç 'rugë, madje ç 'trafik?! Në kohën kur ajo luftë filloi, nuk kishin kaluar veçse pak vjet, që një grusht burrash provuan të lundronin në det të hapur. Natyrisht që u imituan shpejt nga të tjerët, por sado, lundrimet ishin të rralla. Prodhimet bujqësore ishin ende të pakëta dhe nuk kishte arsye që të kishte aq shumë lundrime, sepse nuk kishte aq shumë prodhime e, për pasojë, aq shumë tregti. Të vetmit që rrihnin më shpesh detin, ishin një fis yni, nga veriu, nga tokat Epër, që çonte hidromeli në Athinë dhe mjaltë në anën tjetër të detit, atje ku janë ndërtuar piramidat. Thonë se prodhojnë shumë. Edhe ata që e përdorin (ata përtej detit), konsumojnë shumë. Thonë se me të lyejnë të vdekurit që të mos prishen. Si e pabesueshme duket, por fjalë janë. Vetëm këta kanë lundra të shpejta. Barku i lundrave që ndërtojnë është harkor dhe, sapo harqet ndeshin ujë, bëhet i sheshtë. Kjo do të thotë se nuk zhytet aq shumë, çka i lejon të lundrojë shpejt e të duket sikur rrëshqasin. I kam parë njëherë pra-

në portit tonë: rrëshqasin. Këtë teknikë kanë filluar ta imitojnë edhe të tjerët, por prapëseprapë, lundrat nuk u ecin aq shpejt sa të tyre. Gjithsesi, bëhet fjalë për disa qindra vjet më vonë. E megjithatë, deti nuk rrahët aq shpesh, sa të jetë nevoja për kontroll e dominancë. Mendo në atë kohë... Jooo! Ajo luftë ishte thjeshtë çështje nderi. Jo tjetër.

E fundit: që t'i hysh një aventure të tillë, pra që të përballosh një luftë aq gjakatare, se s'ka si të jetë ndryshe një luftë, e cila ndërmerret nga dy superfuqi, që reciprokisht synojnë dominancë në dete dhe privilegje në ngushtica a porte të të gjitha brigjeve që ai det lag, duhet patjetër të llogaritësh se, me mbarimin e saj, ti do të fitosh, a së paku, pala fituese, do të arrijë më në fund atë që synoi: dominancën. Tjetra u shkatërrua. Punë e madhe! Por tashmë deti ka një zot të vetëm: fitimtarët. Mirëpo fakti është se mbas asaj lufte absurde, të mundurit u shfarosën, ndërsa fitimtarët humbën. Si thamë më sipër, as mund të bëhej më fjalë për flotë mijëra lundërsh; as mund të bëhej më fjalë për ushtri të mirorganizuar prej njëqind mijë vetësh; jo vetëm kaq, por as mund të bëhej fjalë më për aleancë, apo koalicion. Me t'u kthyer, Agamemnoni gjeti vdekjen nga dora e së shoqes, që u hakmor për Ifigjeninë, sakrifikuar aq pabesisht, por më e keqja, aq kotësisht. Me këtë, jo vetëm Mikena, por krejt Akaida nuk ishte më një forcë, as ushtarake, as ekonomike madje. Sparta, tashmë pa Mikenën, nuk mund të konsiderohej e fuqishme. Atridi Menela ngrysi ditët në kështjellën e tij, duke parë nga juglindja dhe duke kujtuar ditët e shkuara... Athina nuk ishte implikuar kurrë në afera të mëdha ushtarake. Lundrat e saj dilnin nga portet për tregti. Dilnin në bregun tjetër për të marrë papir. Kështu, lavdia e qyteteve të Egjeut as mund të krahasohej me atë të paraluftës. Të gjithë ndjeheshin të dërrmuar. Them, nëse kjo do ishte një luftë për dominancë, e jo një luftë e nxehtë pasioni, palët duhet të kishim menduar mirë dhe ftohtësisht përfundimin; duhet të kishin peshuar mirë rezultatin, në mënyrë që fituesi të dilte nga kjo luftë më i fortë. Por koha tregoi se doli më i dobët, madje mund të konsiderohet humbësi i vetëm, meqë pala tjetër u shkatërrua. Ata që thonë se kjo ishte një luftë e nxehtë pasioni, një shkrim dufi nga fyerja, mendoj se kanë të drejtë...

Gjithmonë kam menduar se Atridi Menela, më shumë se me Paridin (po ç 'Parid, more, kush i merrte seriozisht atë stërvitës demash!), ishte fyer me Hektorin, madje, kryesisht me Priamin. Kishte prituri disa ditë, disa hëna. Asnjë mesazh, asnjë shenjë se pala tjetër, dëmtuese, po bën përpjekje të zbusë të dëmtuarin. Asnjë përgjigje. Atëherë, pasi kishin kaluar disa hëna dhe ndoshta një ditë, ishte veshur, bërë gati kuajt dhe ia kishte mbathur në Akaidë, në qytetin e Mikenës, për të takuar të vëllanë. Heshtja e tyre tregonte se ende nuk ishin ndërgjegjësuar që kishin dëmtuar, jo me çfarëdo, por me nder, jo këdo, por Atridin Menela, spartanin...

Kujtdo do t'i dukej e çuditshme se si një qytetërim (pa frikë e them këtë qytetërim), që arrin të ndërtojë sisteme qeverisëse, madje që zgjedhën nga pop-

ulli, e që po i thonë “demokrat” (përse vallë, i shtojnë këto -os, këta jugorët?!); që arrin të ndërtojë qytete që askush nuk i ka parë, madje as ëndërruar; që ka aritur të ndërtojë sisteme ujëtjeje për tokat e mbjella dhe sisteme ujësjellëse, për të shuar etjen e qyteteve pa ujë; jo vetëm kaq, por që ka një shpirt të tillë prej artisti, mes të tjerash e që i ka dhuruar qyteteve ndërtesa të mrekullueshme, teatro e amfiteatro, që e adhuron vetveten në atë pikë, sa të arrijë të quajë njerëzit zota dhe zotave t’u japë pamje njerëzore përmes skulpturave prej mermeri dhe, çka është edhe më e çuditshmja, siç po thonë (le ta marrim për të vërtetë vetëm një çast), që ka arritur ta ndryjë zërin në papir prej kashte e t’ua transmetojë fëmijëve dhe të rinjve si dituri; pra, ky qytetërim, me gjithë këto arritje, të jetë i gatshëm t’i bëjë gjitha këto asgjë, vetëm e vetëm se njëfarë djali (edhe se i pashëm e bir mbreti), grabit një grua (edhe se grua mbreti, madje spartan); vetëm e vetëm se ky mbret, ky spartan, është ndërë i fyer?! Për kaq pak?! Për kaq pak, ky qytetërim, është i gatshëm, jo vetëm të shuhet i tëri, por dhe të mbahet mend për një luftë të tillë, shfarosëse, absurde, gjatë qindra vjetëve (deri tani kanë kaluar gjashtë, kush e di se për sa do të mbahet mend ende), aspak për arritjet e tij, që askush s’i ka imagjinuar më parë?! Vetëm për kaq?! Përgjigja është e thjeshtë. Po! Vetëm për kaq! Ky qytetërim, i lindur nga gjenialiteti, është i gatshëm të shuhet nga marrëzia. Për ta, nderi është më i rëndësishëm se demokracia, lufta absurde më e rëndësishme se bujqësia dhe lavdia në beteja më e rëndësishme se jeta. Në kokat e këtyre njerëzve është në të njëjtin nivel, si urtësia gjeniale, si marrëzia. Nëse i thua këtyre që janë të ulur tani e po pijnë verë, e u kërkon se si ta ndërtojmë më mirë llogaridhënien e qeverisë në senat, në mënyrë që pushteti të mos jetë i grumbulluar në një dorë të vetme e për këtë lehtësisht abuziv, secili prej tyre jep mënyrat e tij se si ta bëjë më mirë atë e të përmirësojë jetën e qytetit. Secili, në mënyra të ndryshme, por njësoj gjeniale. Secili prej tyre mund të ishte fare mirë senator, pavarësisht se mund të jetë bari, tregtar, apo ndërtues. Por, gjithashtu, nëse secilit prej tyre i thua se dikush, ka fyer dikë, së pari të pyet:

- Ku asht dami?
- Punë grash...
- Me ba gati shpatën!

Këtë përgjigje do të jepte pa as më të voglin hezitim. Në vetëdijen e tyre, disiplinimi është rrënjësor si mënyra më e mirë për parandalimin e një krimi edhe më të madh, në parandalimin e shkatërrimit të qytetërimin të tyre, në fund të fundit. Por, duke u mëshuar kësaj pike, nuk e mendojnë se disiplinimi i pamasë dhe pa ndalje dore, është po aq i dëmshëm sa çdo krim tjetër, që madje çon në atë që ata frigojnë më shumë: në shkatërrimin e tyre. Po t’i pyetesh ata nëse Atridët kanë bërë mirë në organizimin e asaj fushate, do të përgjigjeshin pa as më të voglin dyshim:

- Patjetër. Burri për nder jeton!

Nëse do të vazhdoje dhe do i pyesje nëse ju vjen keq për Trojet, që nuk janë më, shndërruar në gërmadha që, edhe pse kanë kaluar gjashtë shekuj, nuk e ka marrë veten ende, e ndoshta nuk do ta marrë

kurrë, shndërruar në vend ku barinj të kullësin të gjallën?! Edhe se do të hezitojnë, sepse thellë brenda tyre e dinë se trojanët ishin vëllezërit tyre, dardanë të veriut, zbritur më në jug se ata, do të thonë me zë jo kumbues:

- Dami lahet me gjak!

Është e kotë. Këta do të vazhdonin prapë kështu. Edhe se tashmë kanë mbetur gjysma e atyre që ishin, edhe se tashmë Frigjia nuk është tokë e tyre, nëse do t’u bëhej thirrje të luftonin kundër argotanëve për një grua, apo kundër danajve për një tufë bagëtish, apo kundër akeive për një pendë kie, nuk do të hezitonin aspak. Do të vononin veç sa të vishnin fustanelën dhe të vinin peleshin në krye (që për ta ishte si një uniformë luftime) dhe do të shkonin. Këtë do ta bënin edhe nëse do ta dinin mirëfilli se do mbetnin gjysma e asaj gjysme që ka mbetur. Dhe përsëri nga fillimi, edhe sikur do ta dinin...

Shkurt, nëse ndonjërit prej tyre do t’i



thuhej se vëllau tij ka zhvendosur gardhin e arës vetëm një këmbë, do të ishte gati të luftonte me të, edhe se krejt arën do t’ia falte me bujari, pa ia kërkuar madje. Për ta nuk është e rëndësishme pasoja, por nderi; për ta është më e rëndësishme t’i respektojë vëllai se vetë vëllai; për ta dëmi nuk qëndron tek një këmbë arë, por tek shpërfillja. Për mungesë respekti të vrasin, për të kundërtën nuk dinë si të të shpërblejnë. Jetojnë mes skajeve, pa njohur të mesmen.

Dëshpërimisht ata janë fanatikë të zbatimit të atij kodi të vjetër nderi. Se sa i vjetër ishte ky kod, askush nuk di të thotë. A vetë e kanë përpiluar ashtu, apo e kanë mësuar prej të tjerëve para tyre, kjo është një pyetje që të vështirë e ka përgjigjen. Kush ishte para tyre?! Ç’ popullsi ata gjetën në tokën që kanë sot?! Askush nuk di të thotë. Po t’u referohesh legjendës, a mitit, ata thonë se kanë lindur në atë tokë, madje janë aty përpara hyjve... Nisur nga kjo legjendë a mit, pritët të bësh pyetjen: këta, a janë krijuar prej hyjve, apo kanë krijuar hyjtë?! Disa të tjerë madje thonë se kanë zbritur me hyjtë, apo nga hyjtë. Sa më thellë t’u futesh në lashtësi, aq më të ngatërruara bëhen fillet e prejardhjes së tyre. E vështirë të shpjegohet, sepse edhe më e vështirë është të kuptohet. Gjithsesi, ishin të vetëdijshëm për lashtësinë e tyre dhe të kodit të tyre... të nderit.

Ishin verbuar prej tij. Se kush qenë ata burra që e patën sajuar, kush mund ta

thotë?! Por e respektonin dhe e përnderonin, thua se qenë ngjizur me të, ushqyer, rritur e forcuar prej tij. Të zbatoje atë kod, ishte më e rëndësishme se vetë jeta, në rend përpara arsyes. Për ta, ky kod ishte bërë pjesë e religjionit. Ashtu siç kryhen ritet fetare, pa u shtyrë të arsyetosh, por i merr të vërteta verbërisht, ashtu u qe bërë edhe ai. Nëse një rregull i atij kodi shkelej, apo edhe nënvleftësohej, duhej përdorur antidoti i shkeljes, që do të thotë ndëshkimi. Për ta ky kod ishte bërë pjesë e jetës. U kishte qëlluar të luftonin pa u urryer, vetëm se e thoshte kodi, u kishte qëlluar të luftonin me njëri tjetrin madje, pa mllef e zemërim, thjeshtë, ashtu si bujku punon tokën.

Mendoj se Akili e kishte kuptuar këtë, edhe se vonë. Përpara tij e pat kuptuar e ëma. Sepse nuk dëshironte që i biri të përfshihej në një konflikt të tillë, e kishte fshehur. Bënë si bënë, e gjetën dhe ia mbushën mendjen.

- Do bëhesh i pavdekshëm, - i thanë.

Qe nisur. Pas nëntë vitesh më në fund kuptoi se po luftonte pa e urryer armikun. Qe shmangur. Sajoi një konflikt me të madhin fare, që të mos luftonte kundër atyre që flisnin gjuhën e tij, që visheshin si ai, që nderonin të njëjtët hyj dhe zbatonin të njëjtin kod nderi. Aspak nuk qe i dashuruar me Briseiden. Madje, as nuk i qe afruar, ndërsa e mbante robinë në tendën e tij. Duke menduar se e ndëshkon për rebelimin, Agamemnoni ia pat marrë. Pa asnjë rezistencë ia kishte dorëzuar. Kjo i kishte mjaftuar si arsye për t’u shmangur.

Në fakt ai dashuronte Polisenën, bijën e Priamit, të cilin kodi i thoshte se duhet ta kishte armik. Nuk e kishte. Në mos për Patroklin, ai kurrë nuk do të luftonte kundër Hektorit. Kurrë! Për nëntë vjet e kishte shmangur... Jo nga frika. As Hektori nuk e kish ngucur. Sikur e kishin kuptuar, sikur kishin bërë marrëveshje të heshtur, për të mos e zbatuar kodin...

Ishte në nderin e çdo luftëtari, aq më tepër mbreti a princi, që në betejë e sipër të thirrte me emër për dyluftim kundërshtarin më të lavdishëm, heroin më të madh. Kjo bëhej për disa arsye: së pari, duke bërë kështu, njëri nga prijësit bie dhe krijohen kushte për të shkurtuar kohën e luftës e, së bashku me të, kurseheshin me qindra jetë; së dyti, duke mposhtur kundërshtarin, ia merr lavdinë, si të thuash, lavdisë së tij i shtohet ajo e kundërshtarit. Sa herë dëgjojmë rapsodët të thonë: Diomedi, bir i Tideut, mundës i vëllezërve Ksanti e

Tones, si dhe Pendarit e Dresit, etj.. Në të gjitha aspektet, edhe kjo ishte pjesë e kodit të vjetër të nderit. Për gjatë nëntë vjetëve Akili kurrë nuk e kishte sfiduar Hektorin. As ky, kurrë nuk e kishte thirrur në emër Akilin gjatë betejave. Kishin thyer kodin, sepse kishim kuptuar anën e tij më kriminale: kapërcimin e së drejtës. Në marrëzinë e tij prej djaloshi, ndërsa Akili ishte në gjumë, mbase edhe i dehur (kishte disa muaj që nuk merrte pjesë në beteja, ndaj kishte kohë mjaftueshëm), Patrokli ia kish marrë fshehurazi armët, rreshtuar një grusht mirmidonësh dhe, sa ka hy në betejë, e ka thirre me emër Hektorin. Ky, megjithëse zëri i ndryshëm fillimisht e bëri të dyshonte, duke parë armaturën karakteristike, ka menduar se është Akili. Duhet të ketë thënë me vete:

- Paska luejt mendësh!

Çfarë ndodhi pastaj është histori.

Ah, Patrokël... Dy burra, dy heronj u shuan nga mendjelehtësia e një adoleshenti, i cili me pasion e gjaknxehësi sfidoi të pamundurën, verbuar nga ky kod.

Ç’e do! Ndërsa ishte shmangur nga betejat, pasi vajtonte mbrëmjeve Hektorin, ashtu si Patroklin, gjente ngushëllim në krahët e Polisenës. Kurrë nuk e kam kuptuar: Paridi, pse e vrau Akilin?! Kam vënë re, në këngët e rapsodëve, por edhe në rrëfimet e të motshëmve, se kjo nuk iu njuh kurrë për trimëri. Nuk e ka vra në betejë, por në një takim dashuror, në pabesi.

Kështu, pas aq e aq shekujsh, pas një konsumimi thuajse total të rendit të vlerave që i përcakton një kohë e dhënë, ai kod për ta nuk shërbente më si rregullator, por si mjet irracional vetëvrasjeje kolektive. Oh, të shkretët! Si duket, kur ua kanë mësuar atë, s’ua thanë të plotë. Nuk u kanë treguar se, më i rëndësishëm se ndëshkimi, është të kuptuarit e dëmit, çka përcakton edhe nivelin e faljes, a siç i thuhet sot, tolerancën. Toleranca, është përpjekja për të mirëkuptuar, a së paku kuptuar rrethanat në të cilat shkaktohet një dëm, qëndron në themelin e çdo ndryshimi, qoftë edhe të kodit, qoftë ky edhe nderi, madje dhe i lashtë. Sikur t’ua kishin mëkuar këtë, do ishte ndryshe. Mbase ajo luftë absurde edhe mund të mos zhvillohej fare...

Por lufta u bë. Për çështje nderi! Një luftë që shfarosi njëren palë dhe nga ku tjetra, fituesja, doli e përgjysmuar. Më e keqja: u vranë, u gjymtuan, u shfarosën pa u urryer. Fanatikë të një mendësie të dështuar, të një nderi i cili dëmton të gjitha palët e s’i duhej më askujt.

Po a nuk e shihni, o të mjerë, se sa pak kemi mbetur?! Nuk do kalojë shumë, nga mrekullia që ishim, prej të cilës nuk ka mbetur as gjysma, nuk do mbesë më asgjë. Më e keqja do të ishte atëherë, nëse, vetëm duke parë mbetjet e qytetërimin tonë, do të thonin:

- Këto i kanë bërë ata...

- Ata, kush? Ata?! Jo, nuk është e mundur!

Dhe, nga krenarë që jemi sot, do t’i shohim me inferioritet të tjerët, që mund të jenë edhe shtatshkurtër...

O Zeus, ç’më shtyn t’i them këto... Ç’fantazi e mbrapshtë më duket se më mbërthen ndonjëherë, si të ishte një dëlir nga zjarrmia. Kurrë mos u bëftë!



MOSTER E PËRÇMIMIT

Vrerë derdhen ulërimat e çakenjëve
Nga llogoret e tyre si predhë gjuan fjala
Kamufluar plot guxim mbi kultin e plagës së turbulluar

Në të fundmen ftohtësi përpin mistiken gri
Horizontet drithëron mes borës a stuhisë
Me flakët e zjarrit të shuar mjegullën bën re

Humori rebel i kësaj bote njerëzore
Mes zbrazëtisë kundërmon gjithë madhështi
Damkosur e thërrmuar shpërthen gjithë fuqi

Astrologët parashikojnë një verë plot rrebesh
Kridhet imagjinata plot ritme dallgësh
Gjarpri helmues ferrin freskon tërë afsh e ndez

Mostër e përçmimit me imazhe engjëjsh
Me skeletin e fjalës mistershëm gërmon
Pezmi në shpirt qiellin shpon ulëritshëm

Ndizen, egërsohen, fjala mbushet me zemërim
Larg duket piku i së pafundmes kohë
Ngjyra e verdhë e Evropës kaloi oqeanet

Anija ballkanike veç sa ka nisur të lëkundet

RIKTHIMI I HIJEVE

U përçart e egërsua gjuha e despotëve
Dëshirë e lashtë ky helmim i fuqisë
Tirani lakmitare tek forcon lëvozhgën, kërkon diell

Si zhonglerë përkëdhelesh me gjarpërinjtë
Martire të përgjakur në shkretëtirë burgose kohërat
U thërrmua fjala e besa nga arkitekti i përrallës

Djep djallëzie ajo trevesa e krimin
Kryeneçësia ta neverit, mjegullbardha zu diellin
Si gjarpri sulmon zemërimi rebel

U ndez bota me ashpërsinë e fjalës
Përbirohet zemra e tokës e gurin e çan
Si me magji davarit deri mbi re

Eh, ç ‘sharlatanizëm ka zaptuar hapësirat

GËRHASIN E KUISIN

Përçudnisht e hijerëndë shpërthen marramendja
Edhe hëna të pështiroset se dritën e fsheh
Marrëzia që rri struktur vërtetësinë dot s’e shpreh

Çdo mjedis e bën të trishtë ajo mostër plot përçmim
Maskë e dekor mbuluar skaj më skaj
Zënkat imiton nën shashka plot me tym

Kridhen universit si nën fuqi të opiumit
Ti pasha i botës së ligë mbi kuaj që rrapëllinë
Shkretëtirën e ferrin e mundën prej zullumit

Pa shpjegueshëm kryqëzuar udhët e epokës së re
Nga ethet flakëritëse dehur në marrëzi
Makthit e përqeshjes i përvidhet me dinakëri

Bashkëfajtorët besnikë kthyer në bishë mizore
Thellë i gërryen shpirti veç gërhasin e kuisin Skëterrë e absurditet
Zhargonin e dyfytërësisë pandeh e degdisin

Në cilën çarshi e ka kufirin kjo harbutëri

NË LOG TË ACARIT

Keq janë tharbëtuar motet ballkanike
Buka e atdheut s’po
S’po vije se s’po vije
Mot i lig mbi re e ne
Lisat janë dëshmi të kohës
Se vaditur qenë me gjak zemre

Nuk erdhi se nuk erdhi asnjë rrugë
Vajti vonë e prapa kohët na përgjojnë
Se hienat s’dinë as të flenë
Në gjoksin e dallgëve kanë zënë vend
Dhimbjet e shpirtit të atdheut
Afërsinë ta ndej thellë në dhimbje
Brenda brigjeve të zbrazëta

Fantazma akujsh ndër ditët me diell
Dritës i zhveshën trungun e mishhtë
Eh kësaj vjeshte me gjethe e ngjyra
Acari mbeti në log të acarit
Mes përmes udhës vet
Pikë për pikë pa zë gëlltiti ajrin

Me mjeshtërinë e vrasjes muzgut
Qosh në qosh Ballkanit vogël
Deri te currilat e fikur në gurë
Zëri ju dëgjua hiri syve ra
Degdisi gjethet mbi degët e thyera
Gjatë udhëkryqeve mbeti e nesërmja
Zot na ruaj nga pamundësia

NË KËTË STINË VJESHTE

Nën optikën e përgjimit ajo palcë e shpirtit
Lodhur e tunduar nga karvanët e covid-it
Në këtë stinë vjeshte
U këputën më gjithë degë si mollë e pjekur

Edhe kjo vjeshtë shkon e kthen me një peng
Zogj me akuj në sqep në ajrin e tharë
Gishtin mos e fut
Në vrimat gozhdëve që nguli vera

Tek thellimi që shtien gjethet
Ngrinin krye gjepurat nën thembra tona
Kokrrizat e hirit kthehen në perla
Për tu ngjitur në qiell
Me ballot shumë ngjyrëshe

Deri më sot sikur jemi ankuar për kohën
Vjeshta mbretëreshë asnjë sekondë botës nuk i fal
Mos prisni në erë diplomatët e dimrit

KJO NGRICË E LARGËSIVE

Ky i ftohti verorë memec e mjaft ziliqarë
Mbështetur fort mbi bërryla
Tek cepi i një shpelle të heshtur rri struktur e plot makth

Në ngricën e largësive
Ata vdesin e varrosen në pritshmëri të akullt murgu ku
vrastare ishin apokalipsa e padukshme e covid-19
Eh ajo pritshmëri e akullt murgu
As mundën kurrë njerëzia t’ju tregojnë se sa shumë ua desh xhani

Në formë avujsh do të ngjitet ky shpirti im i stuhishëm si
një bllok masiv i ngrirë
Dua ta shoqëroj çdo trung të rrëzuar
Nën jehonën e maleve që kërcet e gjëmon nën peshën e
rëndë të apokalipsës që s’ka të ndaluar

Qielli ky altarë i madh
Sa i bukur aq edhe i trishtë
Sheh njerëzinë tek dehen në një gënjeshtër
Dhe krahët të shqyejnë duke përçafuar lavdinë e të
fortëve elitë

Edhe dielli i pa këta të pacipë
Tek përdorin këtë fuqplotë dhe kushedi nga është huazuar
Me mospërfilljen përdore tek zigzakojnë udhëve

NËNË JE E MADHJA DASHURI

(Kushtuar nënës time në 77-vjetorin e saj)
Si këngë të ëmbla violinash zëri yt nënë
Në gji i mban e i përkëdhel kjo mbrëmje
Tek festojmë për ty sonte plot ëndje

Krejt dita iku e dielli në perëndim
Vargjet thur tani për ty mbretëresha ime
Një vit të tërë na mbëlton ëmbëlsi e kësaj dite

Për ty
Ndjenjë e dashurisë mbetet e pashuar
Nënë je si drita që kurrë s’perëndon
Ti engjëll i dëshirës
Që ngjyrat botës i ndryshon

O thesare e pafundme lindur në stinë vjeshte
Sa stina bujare përcolle virtyte
Ishe dhe je nënë motër bijë shoqe apo mike

Engjëll i butë je plot ëmbëlsi
Honet e shpirtit mbushur plot mirësi
Je e mbetesh o dritë e madhja dashuri

O engjëll mëshire plot krahë e vegime
Oaz shpirtit i bëhesh ti zemrës sime
77-vite o yllësi udhëtove me parime

Gjithë stinët nënë u mblodhën në ty
Larminë e jetës ta lexoj ndër sy
Gëzuar nëna ime dita tu bëftë njëmijë

Shtatë jetë po ti kem
Ta them me siguri
Me ndjenjë e përkushtim
Do ti dhuroja ty

REDAKSIA

Kryeredaktore: **LUIGJ SHYTI**
Prelë Milani, Lazer Stani, Roza Pjetri, Lazer Kodra, Zef Nika,
Zef Gjeta, Lulash Brigja, Age Martini, Klodjana Serraj, Vilsan
Peshkaj, Marjan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon
Fierza, Ndue Ziçi, Gazper Marku, Mark Gjeka.

**Mundësoi Botimin:
MHILL SHKAMBI**

